





Implemented by
giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

 **KDWV-OEGJK**
Kosovarisch-Deutsche Wirtschaftsvereinigung
Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare

KANTAR

Roli i diasporës kosovare në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit





Përgatitur nga KANTAR (Index Kosova sh.p.k.)

Përkrahur nga:

Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK)

Financuar nga:

GIZ

Autore:

Vlora Basha

Ekipi i projektit:

Visar Berisha

Qëndresa Haraqia

Blerina Kuçi

Dardan Dervishaj

Dizajni dhe Printi:

Nadire Dyla L.L.C.

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	5
Hyrje	9
Qëllimet	10
Historiku	11
Metodologjia	13
Kapitulli 1: Gjetjet	15
1.1. Ndikimi i përgjithshëm in diasporës së Kosovës në ekonominë dhe mirëqenien e vendit	15
1.1.1. Ndikimi i bizneseve të diasporës në Kosovë	17
1.1.2. Ndikimi i remitancave në zhvillim të vendit	23
1.2. Fasilitimi i investimeve	27
1.2.1. Rastet e humbura	27
1.2.2. Çfarë mund të bëhet?	29
1.3. Kush është Diaspora e Kosovës në Gjermani	31
1.3.1 Një Pasqyrë e Përgjithshme	31
1.3.2 Investimet Potenciale	34
1.4. Të kthyerit dhe migrimi qarkorë	41
1.4.1. Kosovarët e rikthyer dhe të riatdhesuar	41
1.4.2. Migrimi qarkor	45
Migrimi qarkorë	48
Shtojca 1. Pyetsor për hulumtim	51
Shtojca 2. Udhëzues për diskutim	54
Shtojca 3. LETRA E INFORMIMIT	56

Vërejtje

E drejta autoriale © 2021 Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare, Rr. Tirana , Icon Tower, kati 9, Prishtinë/ Kosovë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Ky dokument është përpiluar për Odën Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK), në kuadër të projektit "Reconnect" të përkrahur nga Qeveria Gjermane përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH. Me këtë deklaratë jepet leja për të përdorur, kopjuar dhe shpërndarë përmbajtjen e këtij dokumenti në çfarëdo medie dhe atë pa tarifë, pagesë apo kërkesë formale Bordit të drejtorëve të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare, me kusht që kopjet nuk bëhen apo nuk shpërndahen për fitim dhe me kusht që njihet e drejta autoriale e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare dhe përmendet në burimin e caktuar.

Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare nuk garanton dhe nuk përfaqëson asgjë në lidhje me saktësinë, besueshmërinë apo çfarëdo aspekti tjetër rreth këtij dokumenti. Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare apo anëtarët dhe ose përkrahësit e saj në asnjë rrethanë nuk do të jenë përgjegjëse për çfarëdo dëme të drejtpërdrejta, indirekte, të veçanta, të rastësishme apo rrjedhimore, apo për dëme të çfarëdo natyre që dalin nga përdorimi i këtij dokumenti ose në lidhje me të nën çfarëdo teorie të përgjegjësisë, edhe nëse jemi këshilluar për mundësitë e dëmeve të këtilla.

Përmbledhje ekzekutive

Diaspora kosovare luan një rol të jashtëzakonshëm në jetën e përditshme të qytetarëve të Kosovës, rol ky që është kryesisht i shtyrë nga lidhja emocionale dhe familjare. Megjithatë, kjo lidhje është kryesisht individuale dhe krejtësisht e pa strukturuar, ose në formë të remitancave – para të gatshme ose mallra, ose në formë të shpenzimeve që ata i bëjnë gjatë vizitave të tyre. Përveç ndikimit formal të theksuar në fjalinë e fundit, ndikimi i diasporës konsiderohet domethënës edhe për nga fryma perëndimore që ata e sjellin me vete gjatë vizitave të tyre, e gjithashtu edhe për nga pjesëmarrja në migrimin qarkor dhe investimeve në biznes – të vogla por që ndodhin. Rrjedhimisht, Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK) ka kontraktuar këtë studim duke marrë parasysh që Gjermania është nikoqire e diasporës më të madhe të Kosovës në botë, si dhe duke marrë parasysh që Gjermania është partneri më i rëndësishëm i Kosovës në tregti dhe investime. Misioni i Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK) e nisi këtë studim përmes projektit “Reconnect”, të përkrahur nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik (BMZ), përmes GIZ/ DIMAK.

Qëllimi kryesor i këtij studimi ishte të identifikohen pengesat që janë duke e përmbajtur diasporën nga investimi në Kosovë, por gjithashtu të ofrojë rekomandime për atë se si të shfrytëzohet potenciali i diasporës së Kosovës në Gjermani për

zhvillimin ekonomik të Kosovës, duke i shfrytëzuar remitancat në mënyrë më produktive.

Pse Gjermania? Vlerësohet se më shumë se 400,000 kosovarë jetojnë në Gjermani. Banka Qendrore e Kosovës vlerëson se në vitin 2019 diaspora ka sjellë më shumë se 800 milionë euro në Kosovë, përmes kanaleve formale¹, ndërsa pjesa më e madhe e remitancave (40%) vjen nga diaspora që jeton në këtë shtet. (Banka Qendrore e Kosovës)².

Gjetjet e këtij studimi bazohen në analizën e të dhënave primare të mbledhura duke përdorur dy qasje hulumtuese: hulumtimin kualitativ dhe atë kuantitativ. Fokusi i këtij hulumtimi rrjedh nga hulumtimi kualitativ, ndërsa të dhënat e mbledhura nga hulumtimi kuantitativ janë shfrytëzuar si informata komplementare, për të përmbushur hendekun e të dhënave për një grup specifik të caktuar, diasporën kosovare.

Përderisa gatishmëria dhe interesi i diasporës së Kosovës për të ndihmuar atdheun e tyre mbetet e lartë, përfshirë investimet në biznes, investimet reale në biznes nga diaspora mbesin relativisht të

1 Raporti Vjetor 2019, Banka Qendrore e Kosovës. Retrieved: from https://bqk-kos.org/wp-content/uploads/2020/10/BQK_RV_2019.pdf

2 Raporti Vjetor 2019, Banka Qendrore e Kosovës. Retrieved: from https://bqk-kos.org/wp-content/uploads/2020/10/BQK_RV_2019.pdf

ulëta. Të gjeturat e hulumtimit theksojnë çështjet themelore përtej gjërave të dukshme kur flasim për investimet e huaja dhe të diasporës në biznes. Ajo çfarë e pengon diasporën nga investimi nuk gjendet në njërin hallkë të zinxhirit, por në disa hallka të zinxhirëve edhe ekonomik edhe social.

Nëse e shohim pasqyrën e përgjithshme, një nga pengesat kryesore qëndron në imazhin e përgjithshëm të vendit dhe si jemi të perceptuar nga bota e jashtme, ku nëse i marrim parasysh lajmet dhe emërtimet që i janë dhënë Kosovës gjatë dy dekadave të fundit, imazhi i përgjithshëm i vendit nuk pasqyron një 'vend të mundësive, të sigurt dhe të pa korruptuar'.

Është e pa evitueshme të vërehet që çështjet që kanë të bëjnë me diasporën nuk i përkasin ekskluzivisht asnjë institucioni Qeveritar të Kosovës, por përgjegjësitë janë të shpërndara copë-copë në mes të institucioneve të ndryshme, duke sugjeruar që diaspora nuk mbetet në listën e prioritetëve të askujt.

Ndryshimet e shpeshta të Qeverive kanë pasur ndikim negativ në këtë çështje dhe janë reflektuar në iniciative jo të qëndrueshme dhe të ndërprera, si dhe në një lidhje të dobët në mes të një institucioni kombëtar të vetëm Qeveritar formalisht përgjegjës për çështjet lidhur me diasporën dhe palëve relevante të interesit në këtë çështje, si odat

ekonomike dhe biznesmenët që jetojnë jashtë vendit.

Përveç pengesave të lartpërmendura, raporti gjithashtu thekson çështje më specifike me të cilat ballafaqohet diaspora në seksionin 1.2 të këtij raporti; kryesisht duke u fokusuar në ligjet e paqarta dhe kundërthënëse për regjistrimin e biznesit, që shpesh thirret burokraci, mungesën e sigurisë dhe garantimit të parasë së investuar, pronësinë e diskutueshme të pronave dhe çështjen që merr më së shumti kohë – mungesën e burimeve njerëzore të kualifikuara në sektorët profesional.

Seksioni 1.1 fokusohet në ndikimin e përgjithshëm të diasporës në vend dhe në ndikimin e remitancave në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik dhe social të vendit.

Përderisa varfëria e vendit është e dalluar, nga perspektiva ekonomike, ndikimi ekonomik i remitancave shpesh konsiderohet i parëndësishëm, vetëm pse në shumicën e rasteve ato përdoren për të financuar konsumin ditor dhe duke marrë parasysh që shumica e produkteve të konsumit importohen, shumica e të ardhurave nga remitancat dalin jashtë vendit menjëherë pasi që vijnë në vend.

Në mënyrë të padiskutueshme, remitancat luajnë

rol të rëndësishëm sidomos në zvogëlimin e varfërisë, por disa palë të interesit argumentojnë që kjo zgjidhje mund të jetë e dëmshme në periudhë afatgjate, për shkak se e zvogëlon fuqinë punëtore duke u mundësuar jetesë pa punuar atyre që i pranojnë remitancat.

Në mes tjerash, seksioni 1.1 zbulon disa nga të gjeturat e hulumtimit kuantitativ, ku 17% e diasporës që jeton në Gjermani deklarojnë që ata kanë investuar në një biznes në Kosovë në 10 vitet e fundit. Në seksionin 1.3, kapitull mbi atë se kush është diaspora në Gjermani, ishte tërheqëse të kuptohet se rreth 30% e diasporës kosovare që jeton në Gjermani zotërojnë biznes në Gjermani dhe se një numër i ngjashëm kanë menduar të investojnë në Kosovë në 10 vitet e ardhshme.

Këto dy seksione gjithashtu ofrojnë informata për sektorët e bizneseve në të cilat diaspora nga Gjermania ka investuar edhe në Gjermani edhe në Kosovë, si dhe shtjellojnë në cilët sektorë diaspora planifikon të investojë në 10 vitet e ardhshme. Ishte intriguese të kuptohet që edhe pse ekziston një pajtim i gjerë në mesin e palëve të interesit që investimi i diasporës në biznes është pothuajse jo ekzistues, një pjesë e konsiderueshme e diasporës së Kosovës që jeton në Gjermani (32%) deklaroi që kanë investuar në Kosovë gjatë 10 viteve të fundit. Shumica e investimeve mbesin të pa vërejtura për shkak se ato janë kryesisht investime në biznese të vogla familjare.

Përderisa rreth 32% e diasporës që jeton në

Gjermani kanë themeluar biznese në vendin ku ata jetojnë, gati gjysma e kësaj popullate ka treguar interes potencial për të investuar në Kosovë gjatë 10 viteve të ardhshme.

Seksioni i fundit i këtij raporti (1.4) fokusohet në të kthyerit dhe në migrimin qarkor, si dhe në ndikimin që këto kanë në shoqëri.

Gjetjet e studimit theksojnë komunikimin e gabuar dhe mungesën e koordinimit në mes të palëve të ndryshme të interesit në drejtim të një qëllimi të përbashkët, që rezultoi në shumë punë të pa vërejtur për të gjitha palët e përfshira të interesit, pa përjashtim. Prandaj, rekomandohet që institucionet e Qeverisë qendrore përgjegjëse për çështjet e diasporës dhe investimet e huaja t'i forcojnë më shumë marrëdhëniet e tyre me palët e interesit të diasporës dhe me odat ekonomike (kombëtare dhe bilaterale).

Ekziston një indikacion që plani aktual strategjik i Qeverisë për diasporën 2019-2021 nuk është aq i qartë ose që ka probleme në zbatimin e duhur të tij. Ky plan ka nevojë për konsultime serioze me partnerët strategjik dhe ekspertët e ekonomisë, në mënyrë që të rritet ndikimi i tij dhe në mënyrë që të përpilohet plani i ardhshëm 2022-2024.

Përgjatë tërë studimi është bërë e qartë që ka hendeqe në zbatimin e ligjeve lidhur me investimet e huaja. Këto hendeqe duhet të identifikohen, të eliminohen dhe më me rëndësi, përpjekjet dhe rezultatet duhet t'i komunikohen diasporës.

Lehtësimi i tatimit konsiderohet si prioritet urgjent nga të gjitha palët e interesit të përfshirë në studim dhe konsiderohet si hap konkret drejt tërheqjes së investimeve të huaja. Procesi i marrëveshjes duhet të iniciohet me shtetet relevante, me Gjermaninë në veçanti, në mënyrë që të stimulohet investimi.

Gjithashtu rekomandohet edhe identifikimi i nevojave për burime njerëzore për investitorët potencial dhe krijimi i programeve për plotësimin e hendeqeve në burimet njerëzore.

Është evidente që investimet e diasporës në sektorin e TIK-së janë shumë të ulëta dhe konsiderohet se ata nuk janë të familjarizuar me këtë sektor si mundësi e biznesit. Rekomandohet që OEGJK ta ngushtojë këtë hendek.

Gjithashtu, duhet të konsiderohen politikat progresive për të tërhequr diasporën e kualifikuar që të angazhohet ekonomikisht në vendin e tyre të origjinës, ku do të mund të zbatonin aftësitë e tyre profesionale. Disa nga palët e intervistuarat të interesit besojnë që për fillim do të ishte e mjaftueshme që procesi i rekrutimit në sektorin publik të jetë transparent dhe i hapur që diaspora të aplikojë.

Rekomandohet që Qeveria të komunikojë skemat e saj ekzistuese të përkrahjes për të kthyerit në mënyrë më aktive.

Për fund, por një nga më të rëndësishmet, është e nevojshme që Kosova ta rindërtojë imazhin e

saj pozitiv shtetëror në sytë e diasporës dhe të investitorëve ndërkombëtarë, duke vërtetuar që është duke u zhvilluar një punë intensive në luftën kundër korrupsionit dhe nepotizmit, në përmirësimin e sundimit të ligjit, në rritjen e numrit të profesionistëve dhe në llojet tjera të karakteristikave që ndikojnë negativisht tek investitorët potencial..

Hyrje

Vlerësimet tregojnë se rreth 2 miliardë euro vijnë në Kosovë brenda vitit nga diaspora e saj që jeton anembanë botës, vlerë e përafërt me buxhetin shtetëror të Kosovës për vitin 2021 që kap vlerën prej 2.4 miliardë eurosh. Nga remitancat e diasporës, 41% vijnë nga rreth 400,000 diasporë kosovare që jetojnë në Gjermani dhe konsiderohet një përkrahje për ekonominë.

Përveç vlerësimeve për remitancat dhe vlerësimeve të përafërta për numrin e diasporës që jeton jashtë vendit, shumë pak dimë se kush është diaspora jonë, cili është ndikimi i tyre në atdheun e tyre, a jemi duke bërë mjaft për të inkurajuar përfshirjen e tyre në zhvillimin e vendit tonë dhe më së shumti e rëndësishme, a e kemi idenë se çka ju nevojitet atyre për të qenë më të angazhuar në proceset vendim-marrëse të vendit tonë.


Përderisa diaspora është fokusi ynë i përgjithshëm, në mënyrë që ta kuptojmë problemin, ne e kemi shikuar në veçanti diasporën kosovare që jeton në Gjermani, pasi që ky vend është njëkohësisht shtëpi për shumicën e diasporës kosovare që jeton jashtë vendit.

Në mënyrë që t'i kuptojmë më së miri pyetje tona hulumtuese, është aplikuar hulumtim me metoda të kombinuara, duke zbatuar hulumtimin kualitativ me palët e interesit më relevante për temën, me

qëllim të kuptimit të problemit nga këndvështrimi i tyre dhe hulumtimin kuantitativ me diasporën që jeton në Gjermani, me qëllim të kuptimit të potencialit dhe interesimin e tyre për të investuar në atdheun e tyre.

Ndryshimet e shpeshta të Qeverisë padyshim që kanë pasur ndikim negativ në vazhdimësinë e punës rreth mbajtjes së diasporën më afër. Dhe nëse i shikojmë më mirë nevojat e investitorëve potencial, gjetjet e hulumtimit theksojnë një mospërputhje të madhe në mes të asaj që duhet të bëhet nga Qeveriadhe asaj që aktualisht bëhet, në mënyrë që të nxiten dhe të tërhiqen investitorët ekonomik. Raporti është përplot me ide që fillimisht kanë qenë shumë premtuese që kanë nisur si projekte të mira dhe kanë pasur ndikim premtues në zhvillimin ekonomik të vendit, por kanë dështuar në zbatim, kryesisht për arsye të panjohura.

Në anën tjetër, raporti qartë thekson vullnetin e diasporës dhe gatishmërinë e tyre për të kontribuar në atdheun e tyre. Më shumë se 30% e diasporës që jeton në Gjermani thekson që ata kanë menduar të investojnë në biznes në Kosovë në 10 vitet e ardhshme, por për këtë disa kërkesa elementare duhet të përmbushen paraprakisht, sidomos sundimi i ligjit dhe zbatimin i ligjeve që i favorizojnë investimet e huaja.



Ky raport mund t'ua hapë sytë shumë palëve të interesit, por gjithashtu mund të shërbejë si udhëzues për politikë-bërësit dhe për përpiluesit e planeve të veprimit për kuptuar problemin përtej asaj që është e evidente. Pengesa kryesore që i ndalon investitorët të investojnë në Kosovë është imazhi i dobët i vendit gjatë dekadave të kaluara dhe ky raport është shembull i qartë se si kjo ka ndikuar në vendit tonë.

Qëllimet

Qëllimi kryesor i studimit është të identifikohen pengesat që po e mbajnë diasporën nga investimet në Kosovë, por gjithashtu të ofrojë rekomandime se si të shfrytëzohet potenciali i diasporës së Kosovës në Gjermani për zhvillimin ekonomik të vendit, duke përdorur remitancat në mënyrë më produktive.

Studimi duhet të raportojë për këto çështje:

- Si mund të lidhet diaspora më mirë me vendin e origjinës për të marrë pjesë në zhvillimin e vendit në të ardhmen?
- Si mund të stimulohet diaspora që t'i investojë mjetet e tyre ose t'i lidhin bizneset e themeluara jashtë vendit me vendin e tyre?
- Si mund të përdoren remitancat në mënyrë më produktive?
- Si mund të përfshihet diaspora më mirë për të mundësuar migrimin qarkor?
- Me cilat sfida ballafaqohen të kthyerit dhe si mund të integrohen në mënyrë efektive në ekonominë dhe shoqërinë vendore?
- Deri në çfarë mase mund të ofrojë bashkëpunimi më i ngushtë regjional në sferën politike, ekonomike dhe të shoqërisë civile, si dhe lëvizshmëria brenda Ballkanit Perëndimor, një qasje shpresëdhënëse në luftimin e tendencave ekzistuese të emigrimit?

Gjetjet e këtij studimi do të ofrojnë informata që do të shërbejnë për fuqizimin e kornizës ligjore dhe të politikave, në mënyrë që të tërhiqen dhe të rriten investimet nga diaspora, duke dhënë rekomandime se si të përdoren remitancat në mënyrë më produktive.

Studimi mundohet t'i përgjigjet këtyre pyetjeve hulumtuese:

1. Cilët faktorë ndikojnë (mundësojnë dhe pengojnë) investimet nga diaspora e Kosovës?
2. Aestimulojnë remitancat rritjen ekonomike dhe a i zvogëlojnë çekuilibrimet makroekonomike në Kosovë?
3. Si mund të përdoren remitancat në mënyrë më produktive për të përkrahur zhvillimin ekonomik të vendit në të ardhmen? (Praktikat më të mira nga vendet tjera, që kanë diasporë të madhe.)
4. Si mund të lidhet më mirë diaspora me vendin e origjinës për të marrë pjesë në zhvillimin e vendit në të ardhmen?
5. Si mund të stimulohet diaspora për t'i investuar mjetet e tyre ose t'i lidhin bizneset e tyre të themeluara jashtë vendit me Kosovën?
6. Si mund të përfshihet diaspora më mirë për të mundësuar migrimin qarkor?

Historiku

Marrëdhënia e dashurisë afatgjate e diasporës së Kosovës me vendin e tyre dhe anasjelltas ka qenë enigmë për shume vende për një kohë të gjatë në aspektin e identifikimit të shtytësve të kësaj marrëdhënie.

Megjithatë, ekziston besimi që kjo marrëdhënie është shumë e ndikuar nga rrethanat historike, politike dhe socio-ekonomike. Sidoqoftë, nuk mund të mohojmë që arsyt kryesore të këtij relacioni janë për shkak të kulturës, respektivisht për shkak të vlerave që janë kultivuar në vendin tonë.

Si rezultat i kësaj lidhjeje, ndikimi i diasporës së Kosovës reflektohet edhe në nivelin mikro edhe në atë makro, si dhe ndikimi i saj vazhdon të luajë rol të domethënës jo vetëm ekonomik, por edhe social. Sipas Studimit për Remitancat e Kosovës të UNDP-së (2012)³, ekonomitë familjare në Kosovë marrin dy lloje të remitancave: a) remitanca të dërguara nga emigrantët si para të gatshme dhe b) remitanca të dërguara si mallra, shërbime dhe veshmbathje. Lloji i tretë i remitancave për ekonominë e vendit janë shpenzimet që diaspora i bën gjatë vizitave të tyre në Kosovë.

Në përgjithësi, remitancat në Kosovë gjatë periudhës nga viti 2005 deri në vitin 2019 kanë pasur tendencë të rritjes, duke filluar nga fakti që remitancat në vitin 2005 janë qenë në vlerën prej 418 milion euro, ndërsa në vitin 2019 kanë arritur vlerën prej 851.7 milion euro. Remitancat e pranuar

në Kosovë vetëm në pjesën e parë të vitit 2020 kanë kapur vlerën prej 434.9 milion euro, që paraqet një rritje prej 7.2 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019⁴. Shumica e emigrantëve të Kosovës jetojnë në Gjermani dhe Zvicër, përderisa në mesin e shteteve tjera të popullarizuara janë Sllovenia, Italia, Austria dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Sidoqoftë, Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK) ka ngritur një çështje interesante për hulumtim. Përderisa të gjithë pajtohem që remitancat reflektohen edhe në nivelin mikro edhe në atë makro në ekonominë e Kosovës, pyetja a e stimulojnë në të vërtetë këto investime rritjen ekonomike dhe a i zvogëlojnë çekuilibrimet makroekonomike? Ose thënë më mirë, si mund të shfrytëzohen në mënyrë më produktive për të përkrahur zhvillimin ekonomik të vendit në të ardhmen, për të krijuar vende të punës dhe për të rritur eksportet?

Misioni i Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK) është të forcohen lidhjet bilaterale dhe këmbimi tregtar në mes të Gjermanisë dhe Kosovës. Përmes projektit "Reconnect", të përkrahur nga Ministria Federale e Gjermanisë për Bashkëpunim Ekonomik (BMZ), përmes GIZ/DIMAK, OEGJK synon të kontribuojë në rritjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta nga Gjermania, duke përkrahur Qeverinë e Kosovës në zhvillimin e politikave që do të tërhiqnin investime të huaja, duke promovuar

3 <https://www.kosovodiasporadiaspora.org/study-un-dp-kosovo-remittances-study-2012/>

4 Source: Central Bank of the Republic of Kosovo, www.bqk-kos.org.

Kosovën si lokacion për bashkëpunim dhe investim në Evropën Juglindore.

Prandaj, me qëllimin që të krijohen lidhje më të forta në mes të bizneseve të diasporës së Kosovës në Gjermani dhe kompanive kosovare, përkrahja e partnerëve në forcimin e kornizës ligjore dhe të politikave për tërheqjen dhe rritjen e investimeve dhe lidhja e vendeve në mes veti, si dhe ofrimi i mundësive specifike për investime në Kosovë për bizneset e diasporës dhe ato gjermane, OEGJK inicioi një studim hulumtues për përfshirjen e diasporës në zhvillimin ekonomik të Kosovës në të ardhmen.

Për më tepër, ky studim ka për qëllim të ofrojë analizë të mundësive për krijimin e partneriteteve të reja të biznesit në mes të kompanive nga diaspora, kompanive gjermane dhe kompanive nga Kosova, të promovojë Kosovën si lokacion për bashkëpunim dhe investim në Evropën Juglindore, të rrisë investimet nga diaspora jonë, duke rritur eksportet, duke rritur investimet e huaja të drejtpërdrejta nga Gjermania për të kontribuar kështu në rritjen ekonomike të vendit.

Ky raport synon që të lexohet nga analistët e politikave dhe nga politikë-bërësit, nga palët e interesit të Qeverisë qendrore që punojnë me politikën për diasporën, si dhe të gjitha palët tjera të interesit, përfshirë investitorët potencial për të kuptuar pengesat potenciale që janë duke u diskutuar aktualisht për këtë temë.

Metodologjia

Gjetjet e këtij bazohen në analizën e të dhënave primare të mbledhura duke aplikuar dy qasje hulumtuese: hulumtimin kualitativ dhe atë kuantitativ. Fokusi i këtij hulumtimi rrjedh nga hulumtimi kualitativ, ndërsa të dhënat e mbledhura nga hulumtimi kuantitativ janë përdorur si informata plotësuese për të përmbushur hendekun e të dhënave për grupin e caktuar specifik, diasporën kosovare.

Hulumtimi kuantitativ është aplikuar për të kapur diasporën kosovare që jeton në Gjermani, popullatën e moshës 18+ vjeçare përmes hulumtimit në internet, CAWI (intervistë në internet e ndihmuar nga kompjuteri) për diasporën kosovare.

Madhësia e arritur e mostrës për hulumtimin kuantitativ numëron 500 intervista efektive (intervali i besueshmërisë 4.38%), ku është përdorur mostra e përshtatshme përmes rekrutimit në internet të diasporës kosovare.

Në mënyrë që të arrihen objektivat e studimit është përpiluar dhe është përdorur pyetësi me pyetje të mbyllura, përfshirë këtu edhe 3 pyetje të hapura, me kohëzgjatje mesatare prej rreth 10 minutash.

Të dhënat gjatë procesit të mbledhjes së tyre dhe ngarkimit në server janë kontrolluar dhe janë përpunuar rregullisht nga Menaxheri i përpunimit të të dhënave dhe nga Menaxheri i terrenit.

Duke marrë parasysh që hulumtimi është zhvilluar në internet me popullatën e rritur dhe duke marrë parasysh që procedura nuk ka përfshirë teknika ose procedura invazive, nuk ka pasur nevojë për leje etike nga trupat relevant kombëtarë.

Hulumtimi kualitativ është aplikuar për të nxjerrë analizë të thellë nga palët relevante të interesit, kontributi i të cilëve është konsideruar vendimtar për këtë studim. Janë identifikuar pesë grupe të palëve të interesit dhe një numër i caktuar i intervistave të thella janë realizuar me secilin prej këtyre grupeve, duke rezultuar një gjithsej 20 intervista të thella me:

1. Biznesmenë nga diaspora kosovare që kanë investuar në Kosovë, por jetojnë në Gjermani
2. Biznesmenë nga diaspora kosovare që kanë investuar në Kosovë dhe janë kthyer në Kosovë
3. Ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë të ekonomisë
4. Të kthyerit kosovarë nga Gjermania

Numri i përgjithshëm i intervistave të thella ka qenë 20, ndërsa numri i saktë i intervistave për secilin grup të palëve të interesit është vendosur dhe është miratuar nga ekipi i OEGJK-së që e ka mbikëqyrur këtë studim. Si metodë e rekrutimit është aplikuar mostra e qëllimshme, duke u bazuar në kriteret e popullatës në cak. Për shkak të masave mbrojtëse ndaj Covid-19, shumica e intervistave

(15) janë zhvilluar në internet përmes platformës Zoom, ndërsa pjesa tjetër (5) janë zhvilluar ballë-për-ballë, me kërkesë të pjesëmarrësve në studim. Kohëzgjatja mesatare e intervistave ishte 45 minuta, ndërsa intervistat janë incizuar për qëllime të analizës.

Udhëzuesi për intervista të thella është përpiluar nga temat që janë dizajnuar rreth qëllimeve studimit të specifikuar në kushtet e referencës. Masat e kontrollit të kualitetit janë fokusuar rreth garantimit që të gjitha temat relevante janë përfshirë në instrumentet e hulumtimit, si dhe në punën e dy hulumtuesve në analizën e të dhënave, në mënyrë që të garantohet që janë reflektuar të gjitha aspekte dhe perspektivat e të dhënave të mbledhura në analizën e studimit. Masat e kontrollit të kualitetit në hulumtimin kualitativ gjithashtu kanë përfshirë kontrollin e përzgjedhjes së pjesëmarrësve për intervista të thella, duke u siguruar që ata janë përzgjedhur sipas mostrës dhe që përfaqësojnë llojllojshmëri të sektorëve të ndryshëm relevantë.

Intervistat janë zhvilluar nga tre hulumtues të kualifikuar me përvojë duke përdorur udhëzuesin për intervista. Hulumtuesit, me ndihmën e incizimeve audio, kanë nxjerrë shënime për secilën temë të diskutimit, përfshirë këtu edhe citimet specifike dhe të rëndësishme për analizë të mëtutjeshme.

Analiza është kryer nga hulumtues me përvojë që kanë analizuar shënimet dhe incizimet dhe kanë përpiluar gjetjet nga hulumtimi kualitativ.

Konsideratat etike. Pjesëmarrja në studim ka qenë vullnetare, edhe në hulumtimin kualitativ edhe në atë kuantitativ. Në hulumtimin kuantitativ, pjesëmarrësit kanë zgjedhur të klikojnë linkun dhe të vazhdojnë me plotësimin e pyetësorit, si dhe të tërhiqen nga pjesëmarrja në çdo kohë. Pjesëmarrësit gjithashtu kanë qenë të informuar se si do të përdoren të dhënat dhe u është garantuar konfidencialiteti, duke marrë parasysh që informatat e tyre personale nuk do të ndërliken me përgjigjet e tyre.

Në hulumtimin kualitativ pjesëmarrësve u është ofruar një letër informative gjatë kontaktit të parë, duke ua shpjeguar objektivat e studimit, çështjen e incizimit dhe anonimitetin. Gjithashtu, atyre u është shpjeguar që ata mund të tërhiqen nga hulumtimi në çfarëdo kohe dhe mos-pjesëmarrja e tyre nuk do të ketë efekte negative. Edhe këta pjesëmarrës kanë qenë të informuar se si do të përdoren të dhënat dhe u është garantuar konfidencialiteti, duke marrë parasysh që informatat e tyre personale nuk do të ndërliken me përgjigjet që i japin në studim.

Para fillimit të diskutimit është marrë pëlqimi verbal nga pjesëmarrësit, ku është përfshirë edhe pëlqimi për incizim.

Analiza e të dhënave kuantitative. Të dhënat përfundimtare nga hulumtimi kuantitativ janë vërtetuar në SPSS versioni 26 për Windows, në zyrat e Kantar (Index Kosova) nga Menaxheri për përpunimin e të dhënave dhe nga Menaxheri i projektit. Para analizës, të dhënat janë kontrolluar për të dhëna që mungojnë dhe për të dhëna të veçuara; për të dhënat e veçuara është aplikuar rregulli i etiketimit. Pastaj, të dhënat janë analizuar në SPSS dhe janë ndarë sipas indikatorëve kryesorë si gjinia, mosha, numri i anëtarëve të ekonomisë familjare, a kanë investuar në biznes në Kosovë gjatë 10 viteve të fundit dhe a kanë menduar të investojnë në biznes në Kosovë në të ardhmen.

Analiza narrative është aplikuar për analizën e të dhënave të mbledhura nga hulumtimi kualitativ, nga intervista e thella. Të dhënat së pari janë ndarë në 5 nën-kategori sipas llojit të palëve të interesit. Temat për kodim kanë rrjedhur nga objektivat e studimit, përderisa kodimi boshtor është aplikuar për të lidhur kodet e kategorive ndaras për secilën nën-kategori.

Pastaj, gjetjet janë lidhur me hipotezat dhe objektivat e hulumtimit, përderisa citatet e vlefshme nga transkriptimet janë përdorur për të

theksuar temat kryesore në kuadër të gjetjeve dhe kundërthënive të mundshme.

Kufizimet e studimit. Qëllimi i këtij studimi ka qenë që të identifikohen vështrimet e palëve kryesore të interesit për kushtet e nevojshme për ta bërë Kosovën më tërheqëse për investitorët potencialë dhe për të gjetur mënyra për përmirësimin e klimës së biznesit në Kosovë. Prandaj, gjetjet e hulumtimit kualitativ mund të përgjithësohen vetëm për një popullatë të ngushtë të ngjashme me profilin e palëve të interesit dhe situatës së tyre specifike. Gjetjet e hulumtimit kuantitativ, duke marrë parasysh madhësinë e mostrës (500 anëtarë të diasporës që jetojnë në Gjermani), përfaqësojnë vetëm mendimet e popullatës së diasporës kosovare që jeton në Gjermani dhe jo domosdo aplikohet për mendimin e diasporës që jeton në pjesën tjetër të globit.

Kapitulli 1: Gjetjet

1.1. Ndikimi i përgjithshëm i diasporës së Kosovës në ekonominë dhe mirëqenien e vendit

Ekziston një pajtueshmëri e përgjithshme në mes të ekspertëve të përfshirë në studim se ndikimi i diasporës në Kosovë është ndikim i prekshëm. Këta ekspertë vlerësojnë se Kosova, përpos buxhetit shtetëror zyrtar, ka edhe buxhetin shtesë jozyrtar, e që vjen përmes diasporës së Kosovës dhe arrin pothuajse shumën e buxhetit zyrtar.

‘Diaspora jonë dërgon pothuajse mbi 1 miliardë Euro në vit, që përbën një buxhet shtesë për Kosovën. Do të thotë, Kosova ka buxhetin real the ligjor prej 2 miliardë Euro (vjetor) dhe buxhetin shtesë i cili vjen përmes remitancave nga diaspora. (Zyrtar Qeveritar, nëntor 2020)

Ekspertët vendorë dhe të huaj të përfshirë në studim i referohen diasporës si motor i zhvillimit ekonomik. Ata numërojnë dy kanale kryesore përmes të cilave diaspora ndikon në ekonominë e përgjithshme të vendit: përmes remitancave dhe përmes turizmit.

Banka Qëndrore e Kosovës (BQK) vlerëson se në vitin 2019 diaspora ka sjellë më tepër se 800 million euro përmes kanaleve zyrtare ⁵. Megjithatë,

5 Raporti Vjetor 2019, Banka Qëndrore e Kosovës. Burimi: from <https://bqk-kos.org/wp-content/uploads/2020/10/>

sipas ekspertëve lokalë dhe ndërkombëtarë të përfshirë në studim, kjo shumë konsiderohet të jetë akoma më e lartë nëse llogariten të hyrat nga kanalet jo zyrtare dhe mallrat.

‘Besoj se diaspora jonë kontribuon rreth dy miliardë Euro në vit, ose në formë të parave të gatshme ose përmes mallrave si veturat, aparatet televizive, laptopëve, telefonëve mobil apo paisjeve tjera që janë vlerë e shtuar për ne’ (Ekspert i ekonomisë, nëntor 2020).

Ekspertët ekonomikë të intervistuar megjithatë pajtohen se shumica e remitancave janë të alokuara në konsum dhe rreth 300 milion Euro në mënyrë të barabartë destinohen në blerje të patundshmërisë dhe në ndërtim.

Tutje, zyrtarët qeveritarë të përfshirë në studim vlerësojnë se përqindja më e madhe e remitancave (40%) vjen nga diaspora e Gjermanisë, përderisa 20% e remitancave vijnë nga diaspora që jeton në Zvicër dhe pjesa e mbetur (40%) vjen nga diaspora Kosovare që jeton në vendet tjera të globit, informatë e publikuar edhe në raportin vjetor 2019 (Banka Qëndrore e Kosovës) ⁶.

Për më tepër, edhe pse remitancat në shumicën e rasteve përkrahin konsumin, respektivisht

BQK_RV_2019.pdf

6 Raporti Vjetor 2019, Banka Qëndrore e Kosovës. Retrieved: from https://bqk-kos.org/wp-content/uploads/2020/10/BQK_RV_2019.pdf

përkrahin familjet që nuk kanë të ardhura tjera për ekzistencë, konsiderohet që në fakt diaspora luan rol themelor në reduktimin e boshllëkut në mes të eksportit dhe importit të mallrave dhe shërbimeve në Kosovë.

Sipas zyrtarëve qeveritarë pjesëmarrës në studim, mënyra më direkte për të parë ndikimin e diasporës kosovare është përmes krahasimit të kushteve ekonomike dhe jetësore të ekonomive familjare në fshatra të Kosovës me ato të Malit të Zi, Serbisë apo Maqedonisë. Sipas tyre, dallimi është dramatik kur janë në pyetje paisjet shtëpiake që këto ekonomi familjare posedojnë e që nuk përputhen me të ardhurat e asaj familje.

Për më tepër, ekspertët në studim vlerësojnë se pavarësisht nga pandemia dhe nga fakti që lëvizja e diasporës ishte e kufizuar, rrjedha e remitancave ka vazhduar, duke shënuar kështu ngritje gjatë vitit 2020. Në vitin 2019 remitancat shënuan ngritje për 6.4%⁷.

Arsyeja kryesore e kësaj marrëdhënie të vazhdueshme e diasporës së Kosovës me vendlindje, siç duket nuk është vetëm socio-ekonomike, por më tepër kulturore dhe buron nga familja. Shtrohet pyetja, sa gjatë do të zgjasë kjo

marrëdhënie? Si rrjedhojë e zhvillimit, shoqëritë Perendimore janë shndërruar në shoqëri më individualiste dhe për këtë, disa ekspertë konsiderojnë që kjo lloj përkrahje nga diaspora mund edhe të mos zgjasë.

⁷ Raporti Vjetor 2019, Banka Qëndrore e Kosovës. Retrieved: from https://bqk-kos.org/wp-content/uploads/2020/10/BQK_RV_2019.pdf

1.1.2. Ndikimi i bizneseve të diasporës në Kosovë


Vlerësimet. Në mungesë të vlerësimeve të sakta lidhur me investimet në Kosovë, gjetjet e studimit nxjerrin në pah kundërthënie në perceptimet e ekspertëve dhe investimeve konkrete në Kosovë. Ekziston një bindje e përgjithshme në mesin e ekspertëve të përfshirë në studim se investimi në biznese nga diaspora është relativisht karshi vlerës së remitancaeve dhe karshi potencialit që konsiderohet të ketë diaspora në Kosovë. Ekspertët vendorë dhe të huaj të ekonomisë të përfshirë në studim konsiderojnë se diaspora ishte mjaft aktive gjatë procesit të privatizimit dhe që kompanitë e privatizuara me spin-of special tani janë kryesisht në duar të diasporës. Për të sqaruar më tutje, privatizimi përmes modelit me spin-of special përfshin disa kufizime për blerësin e ri të kompanisë. Pronari i ri duhet të përmbushë obligimet e specifikuar në tender si dhe kushtet në vazhdim: 1. Të ketë ofertën më të lartën nga ofertuesit, 2. Shuma e investimeve paraprake, 3. Të mbajë në punë punëtorët paraprak dhe të rrisë numrin e punëtorëve për një periudhë të caktuar kohore (Dr. Bajram Fejzullahu, Modeli i Zgjedhur i Privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në Kosovë -KTA, 2015)⁸.

Sipas ekspertëve ekonomik të përfshirë në studim, ekziston një përshtypje e përgjithshme që diaspora është e dukshme poashtu në kompani

të mëdha, veçanërisht në fushën e ndërtimit ose në biznese ekzistuese familjare. E megjithatë, pala në fjalë konsideron që ky investim është i pamjaftueshëm përballë potencialit që ka ky grup për investime në mëmëdhe.

Sa i përket kësaj, gjetjet e studimit kuantitativ si segment i këtij studimi theksojnë se përqindje e konsiderueshme e të intervistuarve nga diaspora kosovare që jeton në Gjermani, kanë investuar në biznes në Kosovë në 10 vitet e fundit. Nga gjithsejt 500 të intervistuar nga diaspora kosovare që jeton në Gjermani, 17 përqind deklaruan që ata personalisht, ose anëtarët e tyre të familjes, të kenë investuar në një biznes në Kosovë në 10 vitet e kaluara.

⁸ http://journals.euser.org/files/articles/ejjs_may_aug_15/Bajram.pdf



Grafiku 1: Diaspora që ka investuar në Kosovë në 10 vitet e kaluara

Siç u theksua edhe nga ekspertët, gjetjet e studimit kuantitativ theksojnë që sektori i ndërtimitarisë dhe bujqësisë janë dy sektorët kryesorë, në të cilat diaspora e Kosovës ka investuar më së shumti në Kosovë. Përderisa çereku (25%) i diasporës së Kosovës që jeton në Gjermani dhe që kishte thënë se ka investuar në biznes në Kosovë, kishte alokuar investimet në sektorin e ndërtimitarisë, pak më pak (20%) kishin investuar në bujqësi dhe blegtori, kryesisht përmes bizneseve ekzistuese familjare prezente në Kosovë. Hoteleria (12%), tregtia (7%), patundshmëritë (6%), transporti (5%) dhe turizmi (2%) siç duket ishin sektorë më pak atraktivë për investime në biznes nga diaspora.

Përqindja e diasporës që jeton në Gjermani e që ka investuar në sektorin e TIK-së, është çuditërisht e ultë, duke pasqyruar fokusin dhe programin e Ministrisë së Teknologjisë dhe Inovacionit për vitet 2017 deri në 2021, ku politikë e tyre janë pikërisht investimet e huaja dhe eksporti përmes programeve dhe instrumenteve për të ndihmuar bizneset e vogla dhe të mesme drejt integritit në zinxhirë global dhe avancim të shërbimit për eksport. Përderisa kjo jo-domosdoshmërisht shpjegon pse investimet e diasporës në sektorin TIK janë të ulta, mund të konsiderohet si indikator që diaspora e Gjermanisë nuk është e njoftuar me sektorin e TIK si mundësi investimi.



20%
Bujqesia dhe
Blegtori



25%
Ndertimtari



12%
Hoteleri



10%
Tjeter




7%
Tregti



6%
Patundeshmeri



5%
Transport



4%
IT



2%
Turizem

Grafiku 2: Sektoret e biznesit ku diaspora ka investuar në Kosovë

Si përmbledhje, të gjeturat e studimit kuantitativ kundërshtojnë perceptimet e ekspertëve, të cilët njëzëri pajtohen se investimet në biznese nga diaspora janë jo-domethënëse dhe pothuajse jo-ekzistuese. Mbase mund të konkludojmë që një përqindje domethënëse e diasporës së Kosovës që jeton në Gjermani ka investuar në Kosovë në 10 vitet e fundit, por shumica e investimeve mbesin të pavërejtura, sepse këto janë kryesisht investime në biznese të vogla familjare dhe nuk përdorin odat si ndërmjetësim por i kanalizojnë investimet përmes familjeve të tyre dhe jodomosdoshmërisht i bëjnë formale.

Pengesat. Parë nga aspekti ekonomik, edhe pse remitancat për momentin i sjellin shumë më shumë

Kosovës sesa që i sjellin investimet e diasporës përmes bizneseve, disa ekspertë konsiderojnë se investimi i diasporës në biznes në fakt është investim afatgjatë në njohuri në aspektin e njohurive praktike për punë duke transmetuar kulturë tjetër të punës.

Ekspertët e intervistuar pajtohen se investimi ekzistues nga diaspora e Kosovës është si rrjedhojë e vullnetit të mirë për të ndihmuar vendin, mënyrë për të treguar atdhedashuri apo për të mbajtur dhe forcuar lidhjet familjare dhe jo domosdoshmërisht që klima për investime është e përshtatshme. Në fakt, shumica e ekspertëve të intervistuar konsiderojnë se kushtet momentale për investime në biznese nuk janë aspak të favorshme për

investime të huaja, përfshirë edhe investimet nga diaspora.

Për këtë çështje, ministria përgjegjëse, Ministria e e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, e cila rezultoi si bashkim i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Diasporës në shkurt 2020, duket se kishte qenë e vetëdijshme për pengesat me të cilat është përballur diaspora për investime në Kosovë. Për këtë arsye, u dizenjua plani strategjik për vitin 2019-2021, ku përpos tjerash, plani ka për qëllim fuqizimin dhe përfshirjen e diasporës në promovim të kulturës, traditës, turizmit, aseteve dhe mundësive tjera të investimit në vendlindje dhe si cak ka zhvillimin ekonomik përmes forcimit të bashkëpunimit me diasporën⁹.

Një pengesë e theksuar nga përfaqësuesit e qeverisë qendrore të përfshirë në studim, ishte çështja e imazhit të përgjithshëm të Kosovës në sy të investitorëve në përgjithësi. Sipas këtij grupi të pjesëmarrësve në studim, informatat e raportuara në media për shkallën e korrupsionit dhe për mungesën e sundimit të ligjit në vend, kanë krijuar imazh shumë negativ për vendin, të cilin disa e konsiderojnë të ekzagjeruar dhe me ndikim refuzues tek investitorët potencial.

⁹ Project strategy for DiasporaDiaspora 2019-2023 and Action Plan 2019-2021, Ministry of DiasporaDiaspora and Strategic Investments, 2018 retrieved from http://ambasada-ks.net/at/repository/docs/Projektstrategjia_p%C3%ABr_Diaspor%C3%ABn_2019-2023_dhe_Plani_Li_Veprim-it_2019-2021.pdf

Atë që përfaqësuesit e Qeverisë e quajnë imazh, ekspertët tjerë të intervistuar i konsiderojnë probleme reale dhe i grupojnë në tre çështje dhe pengesa të prekshme për investime të diasporës në Kosovë.

Mungesa e funksionimit të ligjit është një nga pengesat më të mëdha të cilat diaspora, sipas ekspertëve, nuk ka mundur t'i tejkalojë gjatë përpjekjeve të tyre për të investuar në biznes në Kosovë.

'Me iniciativën time dhe në bashkëpunim me Fakultetin e Arkitekturës (në Prishtinë), dy biznese erdhën në Kosovë për të investuar. Ata ishin të interesuar për hapje të fabrikave, por pas hulumtimit të tregut u njoftuan me problemet ekzistuese lidhur me pronat dhe ligjin për hapësirën në të cilën ata donin të investonin. Pas humumtimit ata i panë problemet me pronësi të padefinuar të pronave që ata donin t'i blenin, por edhe me sundim të ligjit. Pas asaj, ata ikën dhe investuan në një shtet që ju ofroi siguri dhe sundim të ligjit'. (Sipërmarrës nga diaspora e Kosovës që ka investuar në Kosovë, nëntor 2020)

Për më tepër, të intervistuarit theksuan se një numër i anëtarëve të diasporës ka provuar të investojë në biznes në Kosovë përmes lidhjeve të tyre në politikë, mirëpo shumica e tyre kishin përfunduar të tradhëtuar.

Një tjetër fushë e identifikuar, në të cilën u gjend boshllëk në përmbushje të nevojave potenciale të

investitorëve të huaj dhe të diasporës ishte aspekti i burimeve njerëzore, respektivisht mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar për të përmbushur nevojat e eksportuesve. Në mënyrë alternative, diaspora e interesuar të investojë duhet t'i përshtatet burimeve njerëzore në dispozicion dhe të zgjerojë seksione të limituara të aktivitetit të tyre biznesor apo të zgjedhë biznes apo model tjetër biznesi me qëllim të adaptimit në atë që është momentalisht në dispozicion në tregun e Kosovës.

'Ka kompani që në Gjermani e kanë ndërtimtarinë si aktivitet primar ndërsa në Kosovë e kanë zgjeruar biznesin në hidroenergji dhe jo domosdoshmërisht aktivitetin e tyre primar në Gjermani'. (Sipërmarrës nga diaspora e Kosovës që ka investuar në Kosovë, nëntor 2020)

'Në rast të eksportit p.sh., ne kemi shumë qendra të thirrjeve që eksportojnë në Gjermani, Zvicër, Austri dhe shtete tjera dhe ky sektor është në rritje. Megjithatë, kur e konsiderojmë eksportimin e shërbimeve më të komplikuar, siç janë testimi i softuerëve dhe zhvillimi i tyre p.sh., ne kemi vështirësi sepse nuk ka punëtorë të kualifikuar për këtë linjë të punës' (Ekspert vendor dhe ndërkombëtar, nëntor 2020)

Pengesa e tretë, e cila u theksua unanimisht nga pjesëmarrësit në studim ishte mungesa e sistemit funksional administrativ, p.sh. burokracia. Sipas shumicës së të intervistuarve në studim, ka shumë 'vajtje-ardhje', kohë të gjatë të pritjes dhe komplikime që dalin në secilin segment të procesit

dhe si të tilla, e bëjnë të lodhshëm gjithë përballjen me administratë.

'Një pjesë e bizneseve që kanë zgjeruar investimet e tyre në Kosovë janë shumë të suksesshme, mirëpo ka akoma shumë hezitime për të investuar në Kosovë dhe kjo është kryesisht për shkak të procedurave burokratike dhe të paqarta, duke filluar nga administrata dhe procesi i regjistrimit' (Sipërmarrës nga diaspora e Kosovës që ka investuar në Kosovë, nëntor 2020)

Si zgjidhje, ekspertët e ekonomisë të përfshirë në studim, besojnë se sistemi i edukimit në Kosovë duhet të ndjekë nevojat e tregut për punë dhe të nxisë departamentet relevante të edukimit dhe zhvillimit profesional, që të përgatisin nxënësit për profilet në nevojë. Odat ekonomike konsiderohen të kenë, potencialisht, ndikim të jashtëzakonshëm në këtë drejtim duke ofruar njohuri më të thellë mbi nevojat e tregut.

Ekspertët e intervistuar pajtohen se ka hapësirë dhe mundësi për investime në biznes, ndikimi i të cilit investim do të ishte shumë domethënës dhe atë jo vetëm në aspektin e zhvillimit ekonomik të vendit, por edhe ekspozimi dhe eksperiencia ndërkombëtare që do të fitonte popullata e që do të përmirësonte njohuritë dhe kulturën e punës. Rjedhimisht, kjo do të hapte mundësi për eksport.

Gjithashtu, sipërmarrësit nga diaspora e Kosovës që tashmë kanë investuar në Kosovë, besojnë se ka shumë mundësi që diaspora mund të kontribuojë

nëse do t'ju jepej rasti.

'Ne kemi shumë kosovarë që jetojnë jashtë dhe që janë në pozita menaxheriale, e që kanë kulturë pune përëndimore, që do të mund të ndikonte dhe kontribuonte në Qeveri ose sektorë të tjerë të ekonomisë së vendit, duke transmetuar njohuritë dhe edukimin e fituar nëse do t'ju jepej rasti' (Sipërmarrës nga diaspora e Kosovës që ka investuar në Kosovë, nëntor 2020)

'Ndikimi i tillë (i investimeve në biznese) nuk është ndikim vetëm në konsum, por më e rëndësishmja është në përvoja (si dhe çfarë). Nëse e krahasojmë këtë investim me faktorët përcaktues të zhvillimit ekonomik të Kosovës, ky lloj investimi radhitet si më i rëndësishmi' (Sipërmarrës nga diaspora e Kosovës që ka investuar në Kosovë, nëntor 2020)

Përderisa këto tre tema të gjera rrjedhën nga studimi kualitativ, vlen të theksohet se disa pengesa të diasporës për investime janë thjeshtë individuale dhe dallojnë nga natyra e linjës së biznesit të palës së interesit, apo situata momentale e tyre, siç janë kreditë me interese të favorshme apo përvojat e tyre të kaluara gjatë përpjekjeve të tyre për të investuar në Kosovë si p.sh. mashtrim potencial ose rast korrupsioni me të cilin janë përballur këto palë.

1.1.3. Ndikimi i remitancave në zhvillim të vendit

Është një pajtueshmëri e përgjithshme në mesin e ekspertëve të intervistuar që remitancat janë jashtëzakonisht të rëndësishme dhe në disa raste qenësore për mbijetesën e shumë familjeve që jetojnë në Kosovë. Element tjetër, mendim i përbashkët i ekspertëve, është se në formatin momental, remitancat bëjnë dëm po aq sa bëjnë mirë sepse e ulin vullnetin e njerëzve për të punuar për një rrogë mesatare të Kosovës ose më të ultë. Shumica e ekspertëve të intervistuar, pajtohen se është qenësore të gjindet një mënyrë e duhur për kanalizimin e remitancave në mënyrë që ndikimi i tyre të jetë më domethënës dhe jo vetëm të mundësojë konsumin ditor.

Në fakt, të gjitha llojet e transfereve nga diaspora që nuk investohen në biznese të cilat do të gjeneronin të ardhura dhe vende pune, përpos atyre që e ulin varfërinë dhe urinë, shihen nga ekspertët si pak të rëndësishme për zhvillim ekonomik dhe në disa raste, në periudhë afatgjate, si të dëmshme.

Për të kuptuar më mirë, po e shpjegojmë filimisht pse disa ekspert besojnë se në periudhë afatgjate remitancat mund të jenë të dëmshme. Pasi që shumica e remitancave dërgohen rregullisht, në formë të rrogës mujore, shumica e dëmit bëhet në zvogëlimin e motivimit për të punuar për rrogë mesatare ose më të ultë. Të shohim këtë shembull tipik: ekonomia familjare me pesë antarë merr remitanca çdo muaj nga 500 euro për disa vjet rresht

tani. Nëse ndonjë nga këta 5 antarë punësohet, gjasat janë që rroga e tyre të mos jetë më tepër se 480 Euro ose më pak, varësisht nga kualifikimet. Përderisa puna e ofruar nuk ofron siguri dhe mbi të gjitha, për secilën herë që del nga shtëpia duhet të shpenzosh për transport dhe ushqim, ekziston edhe rreziku që personi nga diaspora që ndihmon, do ta ndërprejë ndihmën sepse tashmë ka një burim tjetër të të ardhurave. Logjika e thjeshtë tregon se nuk ka llogari të punësohet personi nëse mbështetet në remitanca.

Kjo, përderisa mund të duket si zgjidhje e përkohshme e përshtatshme, në shkallë më të gjërë dhe në peridhë më të gjatë, bën më shumë dëm në popullatë sesa që bën mirë.

Përderisa përfaqësuesit e Qeverisë të përfshirë në studim konsiderojnë që kjo do të shkaktojë problem në të ardhmen, ekspertët tjerë të përfshirë në studim besojnë që ky fakt është problem ekzistues tashmë me të cilin Kosova po përballlet.

‘Nëse remitancat përdoren vetëm për konsum, kjo mund të ketë ndikim negativ që rezulton në zvogëlimin e fuqisë punëtore dhe në varrshmëri ekonomike të cilat do të ndikojnë negativisht në ekonominë e vendit’ (Përfaqësues i Qeverisë, nëntor 2020).

‘Sa i përket vlerave sociale, mendoj se remitancat kanë ndikim negativ sepse e bën popullatën që pranon remitanca, më pak të gatshëm dhe më pak të motivuar për të gjetur punë. Duke pasur të

ardhura të rregullta (nga remitancat), njerëzit nuk janë gatshëm të punojnë për më pak sesa që veq marrin tani’ (Ekspert Lokal dhe Ndërkombëtar, nëntor 2020).

Më tutje, ekspertët e intervistuar pajtohen se ky është problem që kërkon zgjidhje të menjëhershme. Megjithatë, gjetja e zgjidhjes për një problem të këtillë është më komplekse kur analizohen thellësisht implikimet dhe komplikimet potenciale të cilat i ngërthen secila zgjidhje. Për më tepër, disa strategji përfshijnë disa hallka të zinxhirit ekonomik sipas tregimeve të ekspertëve të përfshirë në studim. Mundësitë e kanalizimit të remitancave duken në jenë të panumërta – cili ka një apo dy ide.

Ti shohim skenaret e mundshme të kanalizimit të remitancave. Sipas ekspertëve lokalë dhe ndërkombëtarë të përfshirë në studim, shikuar nga aspekti ekonomik, remitancat nuk e ndikojnë fare ose shumë pak zhvillimin ekonomik të vendit, sepse shumica përdoren për konsum ditor dhe janë kryesisht burim jetësor për ata që i marrin. Marrë parasysh që shumica e produkteve të konsumuara importohen nga jashtë, të gjitha të hyrat nga remitancat dalin nga shteti menjëherë, dukshëm me pak efekt në ekonominë e Kosovës.

‘Nëse Kosova do të prodhonte më tepër, ndikimi i këtyre parave do të ishte më i madh sepse të hyrat do të mbeteshin në Kosovë’ (Ekspert Lokal dhe Ndërkombëtar, nëntor 2020).

Menaxhimi i remitancave nga jashtë, nga një trup i pavarur, në formë të një fondi investiv, u përmend poashtu si një plan potencial. Megjithatë, është e paqartë se si ky fond do të mbulonte mbështetjen e familjeve që mbijetojnë nga remitancat – respektivisht si do të kompensonte konsumin ditor të ekonomive familjare që varen nga to.

Do të ishte mirë që të formohej një fond nga Qeveria e Kosovës i bazuar në Holandë apo Luksemburg ose në Angli dhe të menaxhohej nga kompani eksperte në çështje në mënyrë që të jemi të sigurtë që fondet janë të sigurta. Ideja është që të krijohet një fond investiv me projekte konkrete, entitet publik ose privat. Ka projekte të mira publike që do të mund të implementoheshin siç është Termocentrali i Kosovës, përderisa investimi do të bëhej nga paratë e diasporës. (Ekspert Lokal dhe Ndërkombëtar, nëntor 2020).

Por ekspertët tjerë ekonomik e konsiderojnë këtë plan si mjaftë ambicioz, kryesisht për faktin se paratë nga diaspora nuk vijnë të tubuara në shuma të mëdha – do të thotë, ne nuk marrim transaksione me miliona Euro në Bankë Qëndrore por ato dërgohen në shuma të vogla, të dedikuara për konsum ditor.

Një sugjerim tjetër ishte të punohej në vlera sociale, dedikim të remitancave, p.sh., të ketë marrëveshje në mes të dërguesve dhe marrësve. Me këtë nënkuptohet që dërguesi duhet t'i dedikoj remitancat për investime në biznes familjar, me qëllim të blerjes së paisjeve për punë, që do të

pavarësonin familjen e marrësit të remitancave në periudhë afatgjate. Blerja e bagëtive, traktorëve ose makinerive tjera prodhuese që do të gjeneronin të ardhura në të ardhmen, duket si alternativë e arsyeshme. Për më tepër, dërgimi i remitancave si bursë e obligueshme për shkollim të një anëtari të familjes, sipas ekspertëve të ekonomisë, do të kishte ndikim mahnitës në periudhë afatgjate.

Megjithatë, janë dy sfida potenciale për realizim e kësaj ideje. Mikromenaxhimi dhe vetëdijësimi i diasporës për kanalizimin e remitancave dhe vetëdijësimi i personave që mbijetojnë nga remitancat që është më mirë të paguajnë për shkollim sesa për konsum të ushqimit, është proces që merr shumë kohë që kërkon përkushtim.

Disa ekspert besojnë se zgjidhja e problemit të ri-drejtimit të të hyrave nga diaspora, nuk kërkon ndonjë zbulim shkencor. Sipas tyre, replikimi i modeleve të përdorura nga Irlanda, Armenia ose Turqia, do të përmirësonin dukshëm situatën momentale.

'Shtetet si Irlanda, Armenia dhe sidomos Turqia në kohët e fundit kanë arritë të shfrytëzojnë diasporën e tyre jashtëzakonisht shumë, duke krijuar politika dhe ide të qarta si p.sh. janë krijuar klube të hapura për diskutime dhe për organizime, ku mbliohen qytetarët që jetojnë në Gjermani dhe diskutojnë për problemet, sfidat por edhe për projekte ku gjermano-folësit turk, marrin projektet nga Gjermania dhe i dërgojnë në Stamboll me një kosto shumë më të vogël. Kështu përfitojnë ata që e kanë fitu projektin në Hamburg, dhe e realizojnë në Stamboll ku i lidhin kompanitë turke në Stamboll me ato gjermane në Hamburg si ndërmjetësuese. Qytetarët gjerman, si dhe ata turq, përfitojnë të dy palët me shkëmbimin e projektit, stafit dhe realizimit të projektit me kosto më të vogël. Këtu kemi "triple win situation"- është situatë kur kemi tre fitues, pra fiton gjermani që ka realizu projekte me kosto më të ulta, fiton turku gjermano-folës që e ka dërgu si ndërmjetës projektin në Stamboll dhe përfiton edhe kompania turke me implementimin e atij projekti. Në këso projekte, ka pasur së fundi me miliona para të përfituara, jo me shuma të vogla. Pastaj kohë pas kohe janë formuar lidhje të ndryshme duke hapur hotele, restorane, investime në ndërtim, tregtare, bashkëpunime unversitare, etj. Ndërsa ne kemi probleme të shumta... ose nuk kemi një databazë të të dhënave me biznese në Kosovë, që mund të bashkëpunojnë me ato në Gjermani, siç është p.sh. rasti kur një kompani në Gjermani ka kërkuar të gjejmë ne një kompani nga Kosova për dyer të ndërtesave. Për të siguruar ne një kontakt të tillë, duhet kontaktuar së pari Odën Ekonomike Gjermano-Kosovare, pastaj oda, insti-

tucionin përgjegjës, pastaj kompania të kontaktohet, etj., etj. Pra, procedura burokratike dhe mungesa e databazës së saktë, ku kishte me qenë qasja dhe kontakti më i lehtë dhe direkt me kompaninë në fjalë, ku do të kisha pasur mundësi të gjej dhe të them, "kjo kompani qenka me licencë, cilësi dhe me autorizim nga shteti që lejon këto punë t'i kryejë edhe në Evropë." (Sipërmarrës nga diaspora e Kosovës që ka investuar në Kosovë por jeton në Gjermani, nëntor 2020)

Marrë në përgjithësi, ky seksion i raportit është i stërmbushur me fjalë 'do të duhej' dhe 'nëse', gjë që reflekton mungesë të strategjive të menduara mirë dhe mungesë të diskutimit lidhur me skenarët për opsionet potenciale të kanalizimit të remitançave nga ekspertët. Përderisa ka mospajtime fillimisht lidhur me ndikimin e remitançave në përgjithësi, opsionet se si duhet të kanalizohen këto në mënyrë që të jenë më efektive, mbesin të panumërta dhe vetëm si ide të përgjithshme.

1.2. Mundësimi i investimeve

1.2.1. Rastet e humbura

Kur shikohen të gjeturat e studimit prej aspektit se sa është bërë deri tani nga Qeveria e Kosovës, sa i përket përkrahjes së bizneseve ekzistuese nga diaspora, si dhe në drejtim të mundësimit dhe stimulimit të investimeve të reja nga diaspora, çdo gjë është shumë e qartë. Shumica absolute e ekspertëve të intervistuar pajtohen se investimet nga diaspora, por edhe nga kompanitë e huaja, nuk kanë qenë asnjëherë prioritet për Qeverinë e Kosovës. Në fakt, shumica e tyre besojnë se këto nuk ishin prioritet për asnjë institucion. Në anën tjetër, disa zyrtarë qeveritarë nga ministritë relevante besojnë se deri tani, krahasuar me shtetet tjera në regjion, Kosova është dukshëm më e avancuar në promovimin e investimeve dhe bizneseve nga diaspora.

Përpos Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, si ministri e dedikuar për punë dhe promovim të investimeve dhe bizneseve të diasporës, në vitin 2013, u themelua Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve (KIESA), me qëllim të përkrahjes dhe promovimit të investimeve, eksportit dhe turizmit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Për më tepër, ministria e dedikuar për këtë çështje ka bërë përmirësime të mjaftueshme në këtë drejtim përmes Strategjisë së Projektit për Diasporën 2019-2023 dhe Planit të Veprimit të dizenuar më 2018. Poashtu, përfaqësuesit e

qeverisë të intervistuar në këtë studim theksojnë numrin e madh të takimeve që kishin me bizneset e diasporës, e që kishin për qëllim të siguronin këto biznese që mund të llogarisin në përkrahjen e plotë të Qeverisë, nëse do të kishin interesim për të investuar në Kosovë.

‘Që nga viti 2010, kemi bërë përpjekje që të marrim hapa konkretë dhe të ftojme bizneset e diasporës të investojnë në Kosovë, duke u shpjeguar që fokus i diasporës është Kosova, ka qenë dhe do të jetë gjithmonë. Unë personalisht kam takuar biznese shumë të forta... kompani me mijëra punëtorë’ (Përfaqësues i qeverisë, nëntor 2020)

Një tentim domethënës që është bërë nga institucionet dhe që theksohet nga ekspertët e intervistuar, që kanë investuar në Kosovë, por që vazhdojnë të jetojnë në Gjermani, është rrjeti i bizneseve të diasporës që ka filluar në vitin 2014/15. Kjo iniciativë u lansua nga Ministria e Diasporës në atë kohë dhe arriti të kapë edhe bizneset e diasporës së Kosovës në Amerikë dhe Australi, mirëpo fatkeqësisht, dështoi të krijonte strukturë të përhershme dhe vazhdimësi të punës, për shkak të mungesës së mbështetjes së ministrisë në organizim.

‘Fatkeqësisht, nuk ka vazhdimësi të mbështetjes së këtyre rrjeteve me udhëzime të duhura nga ministria përkatëse, respektivisht Ministria e

Diasporës dhe ka mungesë të bashkëpunimit të këtij rrjeti me vetë Ministrinë. Pra, këto biznese provojnë të vetë-organizohen, mirëpo kjo nuk mjafton' (Sipërmarrës nga diaspora e Kosovës që ka investuar në Kosovë por jeton në Gjermani, nëntor 2020)

Përpos elementeve të lartpërmendura, ekspertët e intervistuar përmendën në mënyrë sporadike benefitet e procesit të regjistrimit të diasporës, tentim ky që ka për qëllim të kuptohen më mirë profilet e tyre dhe të identifikohen mundësitë, përmes së cilave këto biznese do të ndikonin në zhvillimin e vendit. Ekspertët deklaruan se ky proces i regjistrimit ka filluar tre vite më parë, por siç duket është ndërprerë për shkak të vështirësive që ka hasur projekti në proces.

'... kur përfundon procesi i regjistrimit të diasporës së Kosovës, ne do të kemi rezultate ose do të kemi databazë e ndoshta edhe rrjet të profesionistëve, me ç'rast qeveria dhe institucionet relevante do të dinë çfarë lloji të profesionistëve kanë, si dhe cilat janë aftësitë e tyre profesionale që i kanë marrë në Bashkimin Europian dhe si do të mund të kontribuonin në ekonominë e Kosovës (këta profesionistë)' (Përfaqësues i qeverisë, nëntor 2020)

Një tjetër tentim i pasuksesshëm për përmirësim domethënës në lidhjen në mes të Kosovës dhe

investitorëve potencial nga diaspora u ndërpre në vitin 2020, por në këtë rast për shkak të pandemisë Covid-19.

'Një mundësi dhe projekt u humb këtë vit, i cili ishte promovimi i parkut inovativ të biznesit në Prizren, ku janë 5000 metra katrorë tokë dhe logjistika gjermane e dedikuar për trajnim profesional, në mënyrë që të vendosen administratat e investitorëve potencial gjerman' (Përfaqësues i qeverisë, nëntor 2020)

Përderisa të intervistuarit nga qeveria qendrore listuan numrin e aktiviteteve të ndërmarrura nga qeveria në këtë drejtim në bashkëpunim me institucionet relevante, secila nga deklaratat e tyre përfundon duke theksuar që puna e bërë megjithatë ishte e pamjaftueshme deri tani, kryesisht si pasojë e mungesës së një plani strategjik dhe për shkak të jostabilitetit politik nga i cili ka vuajtur vendi në dy dekadat e fundit. Me sa duket, ka mungesë të një vlerësimi të përgjithshëm të politikave dhe të ndikimit që ka diaspora në përgjithësi dhe bizneset e diasporës në veçanti në popullatë.

'Marrë parasysh faktin që qeveria nuk është stabile në Kosovë, kjo poashtu shkakton problem në investime dhe në ekonomi të përgjithshme, si dhe në imazhin e Kosovës në sy të ndërkombëtarëve' (Përfaqësues i qeverisë, nëntor 2020)

Sa i përket asaj se çfarë duhet të bëhet më tepër, do të thoja që ne si institucion ndonjëherë nuk kemi ide çfarë duhet të bëjmë, po as ata (investitorët kosovarë në diasporë) nuk dijnë çfarë duan. Më e mira është të ulemi dhe të diskutojmë idetë dhe projektet që do të mund t'i implementonim së bashku. Nganjëherë është konfuzë kush dhe si duhet të bëhen gjërat' (Përfaqësues i qeverisë, nëntor 2020)

Në anën tjetër, sipërmarrësit nga diaspora, të kthyerit nga diaspora dhe ekspertët ekonomikë të përfshirë në studim, nuk e njohin punën e institucioneve publike në këtë drejtim, që tregon se performanca e qeverisë nuk është domethënëse ose jo në drejtim të duhur.

Për të përmbyllur këtë seksion, vlen të përmendet se për arsye të ndryshme shumë iniciativa të Qeverisë së Kosovës për të adresuar qështjet e diasporës u ndërprejnë dhe në shumicën e rasteve për shkak të ndryshimeve të shumta në qeverisje, e të cilat u reflektuan në këtë sektor poashtu. Kjo nënkupton që kryesuesi i kësaj çështje është qeveria. Qeveria është faktori më i rëndësishëm (ndoshta i vetmi) që ka fuqi të mobilizojë palët e interesit që janë më relevante dhe të shtyej punën përpara. Pa punën e këtij institucioni, puna e palëve tjera të interesit mbetet pak e dukshme.

1.2.2. Çfarë mund të bëhet?

Barierat e investimeve të huaja dhe diasporës, siç duket nuk janë tregim i panjohur për palët e interesit të intervistuar në këtë studim, përfshirë këtu edhe përfaqësuesit e qeverisë. Shumica e përfaqësuesve të qeverisë të përfshirë në studim, janë të vetëdijshëm se në mënyrë që të jemi tërheqës për investimet e huaja dhe nga diaspora, qeveria duhet të bëjë punë serioze në zbatim të ligjeve dhe në përmirësimin e imazhit të përgjithshëm të vendit. Vështirësia kryesore duket të jetë të mënyra se si të bëhet kjo. Të gjeturat nga intervistat tregojnë disa mënyra të mundshme se si mund të realizohet kjo përmes polikave të orientuara në këtë drejtim.

Edhe pse bizneset e diasporës u siguruan, sipas ekspertëve, për përkrahjen e plotë të qeverisë në rast të investimeve potenciale, premtimet me fjalë janë të pamjaftueshme kur janë në pyetje investimet serioze. Nevojat e bizneseve të diasporës duket të jenë më të prekshme, e që kërkojnë infrastrukturë të mirëfilltë dhe rregulla ligjore për investimet e tyre, të cilat përkthehen pastaj në siguri për investimet e tyre.

‘Qeveria nuk ka punuar mjaftueshëm për të mundësuar dhe për të nxitur investimet nga diaspora, si dhe të tërheqë investimet e huaja në përgjithësi. Ajo që i nevojitet secilit investitor, e në këtë rast specifik investitorëve nga diaspora, është siguria ligjore dhe financiare (pikë së pari). Kështu që, Qeveria e Kosovës duhet të krijojë ambient ku

mbizotëron transparenca dhe ligji ... një element tjetër që injorohet nga institucionet tona, por edhe nga sektori privat në përgjithësi, është ligji mbi të drejtat e pronësisë intelektuale’. (Përfaqësues i qeverisë, nëntor 2020)

Në fakt, sipërmarrësit e Kosovës në diasporë e që kanë investuar në Kosovë, deklarojnë se ky ligj tashmë ekziston në letër, mirëpo nuk zbatohet.

Përderisa përfaqësuesit e Qeverisë dhe investitorët flasin për zbatimin e ligjit dhe sigurinë e investitorëve në terma të përgjithshëm, mungojnë shembujt specifik se çfarë mund të përfshijnë këto dy elemente, ose janë të pakta. Në mesin e tyre është krijimi i një departamenti specifik që merret me promovimin e mundësive dhe investimeve në Kosovë, në veçanti për sektorin e turizmit.

‘Kosova ka 5 zyra konsullore në Gjermani dhe do të ishte mirë nëse e hapim një sektor (department) specifik për promovimin dhe lansimin e mundësive për investime në Kosovë, veçanërisht në sektorin e turizmit, i cili në Kosovë nuk përkrahet shumë edhe ashtu’ (Përfaqësues i qeverisë, nëntor 2020)

Në anën tjetër, ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë të intervistuar, besojnë që secila strategji e zhvillimit nga qeveria duhet të konsultohet paraprakisht nga komuniteti i biznesit në Gjermani përmes odave ekonomike dhe organizatave, në mënyrë që të kuptohen sfidat dhe problemet me të cilat përballen investitorët potencial dhe rezultatet e konsultimeve të

përkthehen në objektiva të cilat ndiqen pastaj.

Krijimi i gjykatës komerciale që punon në shpejtësi është edhe një hap kyç që mund të nxis investimet e huaja. Ekspertët ekonomik vendorë dhe ndërkombëtarë të intervistuar për këtë studim, konsiderojnë se për kompanitë e mëdha dhe të huaja është e rëndësishme të kenë gjykatë që merret me lëndët e tyre menjëherë. Periudhat e gjata të pritjes së vendimeve të gjykatës dhe procedurat e gjykatës konsiderohen dekurajuese, sepse ju shkaktojnë kumbje financiare këtyre kompanive.

'Rregullimi i gjyqësorit dhe gjykata komerciale si iniciativë është shumë e rëndësishme dhe ideja është ta kemi (gjykatën komerciale) vetëm për padi gjyqësore që tejkalojnë shumën 1 milion Euro. Investitori që vjen nga Gjermania ose Zvicra, kur e di që duhet të pres shumë gjatë, është problem. (Ekspertë lokalë dhe ndërkombëtarë, nëntor 2020)

Një tjetër element nxitës për investime të huaja është nënshkrimi i marrëveshjeve për tatim të dyfishtë me shtetet e investitorëve potencial. Me fjalë të tjera, burimet e të hyrave nga jashtë duhet të lirohen nga tatimet për të hyra nga jashtë ose të ofrohet kreditimi i tatimit të huaj për tatimet e paguara në të hyrat nga jashtë. Në këtë aspekt, gabimet siç janë anulimi i marrëveshjeve ekzistuese për tatim të dyfishtë, të cilat janë bërë në të kaluarën, konsiderohet si tjetër element, të cilit qeveria duhet t'i ikë, në mënyrë që të tërheqë

investime të huaja. Sa i përket Gjermanisë, marrëveshja e tatimit të dyfishtë që nga koha e Jugosllavisë mbetet akoma në fuqi, përderisa marrëveshja pasardhëse është duke u përgatitur.

'Qeveria duhet të bëjë marrëveshje me shtetet, ku diaspora është më e përqendruar në tatim të dyfishtë dhe të mos anuloj marrëveshjet e mëhershme, siç është ajo me Holandën, me arsyetimin se është marrëveshje e trashëguar nga ish-Jugosllavia' (Ekspert Lokal dhe Ndërkombëtar, nëntor 2020)

Një hap tjetër më specifik në të cilin qeveria do të duhej të fokusohet, në mënyrë që vendi të jetë tërheqës për investime të huaja dhe nga diaspora, është investimi në parqe të bizneseve, pasi që ky konsiderohet destinim i rëndësishëm i parasë publike. Gjithashtu, infrastruktura hekurudhore për shembull, është e domosdoshme, sepse kjo do të përmirësonte qarkullimin e mallrave dhe konsiderohet që qeveria nuk ka bërë asgjë në këtë drejtim.

Përderisa roli i odave ekonomike dhe shoqatave të diasporës është i rëndësishëm, funksioni i tyre në këtë fazë konsiderohet nga ekspertët e përfshirë në studim si sekondar krahas rolit emergjent që ka qeveria dhe politikat e tyre. Gjetjet e studimit megjithatë rekomandojnë një bashkëpunim më të thellë ndër-institucional, në mënyrë që të mundësohet dhe t'ju ofrohet shërbim më i mirë investitorëve potencial.

'Oda Ekonomike Gjermano–Kosovare ka krijuar partneritet të fortë me shumë institucione dhe investitorë nga diaspora, duke ofruar qasje në informata relevante për biznese dhe asistimi i tyre në forma të ndryshme, përderisa institucionet tjera kanë bërë më pak në këtë drejtim' (Përfaqësues i qeverisë, nëntor 2020)


1.3. Kush është diaspora e Kosovës në Gjermani

1.3.1 Një pasqyrë e përgjithshme

Është vlerësuar se më tepër se 400,000 kosovarë jetojnë në Gjermani dhe të dhënat nga Banka Qëndrore e Kosovës rregullisht tregojnë se më tepër se 40% e remitancave vjetore në Kosovë vijnë nga Gjermania.

'Më tepër se 400 mijë banorë nga Kosova jetojnë në Gjermani me shtetësi të ndryshme, ose me nënshtetësi të Kosovës, me shtetësi të dyfishtë (Kosovare dhe Gjermane), ose me shtetësi Serbe por që janë nga Kosova. Sipas të dhënave tona, më tepër se 41% e remitancave të përgjithshme që dërgohen në Kosovë, dërgohen nga Gjermania, 20% nga Zvicra dhe të tjerat nga shtetet tjera. Kjo do të thotë se Gjermania mban barrën kryesore të dërgimit të remitancave në Kosovë.' (Përfaqësues i qeverisë, nëntor 2020)


Në mesin e të anketuarve në studimin tonë, pothuajse gjysma e diasporës së Kosovës që jeton në Gjermani jeton në ekonomi familjare të përbëra nga 4-5 anëtarë (48%), përderisa më pak (15%) jetojnë në ekonomi familjare që përbëhen nga 1-3 anëtarë ose më tepër se 6 anëtarë (19%).




Grafiku 3: Madhësia e ekonomisë familjare të respondentit

Një përqindje e konsiderueshme e diasporës së Kosovës që jeton në Gjermani e që ju përgjigjën studimit tonë (32%) raportuan që ata ose ndonjë anëtarë i familjes së tyre ka në pronësi biznes privat në Gjermani, përderisa pjesa tjetër punojnë për dikë tjetër.

Nga 32% e ekonomive familjare që posedojnë biznes në Gjermani, pjesa më e madhe (44%) investimet i ka të orientuara në sektorin e ndërtimtarisë, përderisa pronarët tjerë janë të shpërndarë në sektorë të tjerë. Rreth 12% e pronarëve të bizneseve nga diaspora që jetojnë në Gjermani janë të orientuar në sektorin e hotelerisë dhe më pak (9%) në sektorin e shërbimeve. Gjithashtu, bizneset tjera në Gjermani në pronësi të diasporës së Kosovës janë të shpërndara pak a shumë njëjtë në sektorët siç janë teknologjia informative (4%), tregtia (4%), mjekësia (4%), patundshmëritë (3%), fabrika (3%), tregti veturash (3%) dhe transport (2%).



Grafiku 4: Diaspora që posedon biznes privat në Gjermani, sipas gjinisë



Graf 5: Sektorët e biznesit në Gjermani ku diaspora është investitor


1.3.2 Investimet potenciale

Pa diskutim, ndikimi potencial i diasporës në Kosovë konsiderohet të jetë tejte i rëndësishëm, ose në formë të investimeve, punësimit ose në formë të transferit të njohurive. Të zhvendosim vëmendjen tek Gjermania për shembull: largimi i Kosovës nga lista e zezë e sigurisë gjermane automatikisht ngrit mundësinë e marrjes së investitorëve potencial.

'Kosova ka qenë në listë të zezë të Gjermanisë deri në janar të vitit 2020, që do të thotë se konsiderohej si shtet me rrezikshmëri të lartë për Republikën Federale të Gjermanisë, gjë që e vendoste Kosovën në pozitë të pafavorshme për investime. Por, nga 1 janari 2020, ne nuk jemi pjesë e asaj liste dhe kjo shënon avancim domethënës për shtetin tonë, i cili do të rrit gjasat për investime potenciale në Kosovë nga investitorët gjermanë. (Përfaqësues i qeverisë, nëntor 2020)

Në anën tjetër, gjetjet e studimit kuantitativ me diasporën e Kosovës, nxjerr në pah se, gjysma e diasporës së intervistuar që jetojnë në Gjermani kanë menduar të investojnë në Kosovë në 10 vitet e ardhshme (44%), përderisa të tjerët kanë ndarë mendjen që nuk do të investojnë (51%) dhe një përqindje e vogël refuzuan të përgjigjen (5%).

Përderisa interesimi i diasporës për investime në biznes në Kosovë në 10 vitet e ardhshme duket optimist dhe ndoshta pak euforik, kjo është indikator i qartë i interesimit të tyre të përgjithëm në përfshirje më të thellë në procesin e shtet-ndërtimit.



Grafiku 6: Diaspora në Gjermani që mendon të investoj në biznes në Kosovë në 10 vitet e ardhshme


Kur u pyetën për pengesat p.sh., pse nuk mundën të investonin në biznes në Kosovë deri tani, përgjigjet e respondentëve nga studimi kuantitativ përputheshin me pengesat e përmendura nga ekspertët, të cilat u theksuan më herët në këtë raport.

Nga ata të cilët menduan të investojnë në biznes në Kosovë (44%), edhe pse interesimet ishin të ndryshme, shumica ishin të interesuar të investonin në bujqësi dhe blegtori (27%).

Pjesa tjetër e diasporës që kishte menduar të investonte në një biznes në Kosovë, kryesisht shprehën interesim për investime në fabrika (16%), ndërtimtari (9%) dhe hoteleri (8%).


Interesimi për investim në sektorin profesional, respektivisht për shërbime profesionale, ku

kërkohej që shumica e stafit të ketë shkollim profesional dhe licenca, si dhe shkathtësi specifike siç janë arkitektë, kontabilistë, inxhinierë, mjekë, avokatë dhe mësime dhënë, është më i ultë krahasuar me sektorët e përmendur më herët. Interesimi në investimet e sektorit të informimit dhe teknologjisë (5%) dhe mjeksisë (5%) është më i ultë, por prapë më i lartë se interesimi për investim në tregti (4%) dhe turizëm (4%).



Grafiku 7: Sektori i biznesit i preferuar për investim në Kosovë nga diaspora


Nga ata që menduan të investonin në biznes në Kosovë në 10 vitet e ardhshme, kërkesa më e shpeshtë e tyre për veprim ishte funksionimi më i mirë i ligjit (12%). Lehtësimet në tatime (5%), qasja në kredi me norma interesi të volitshme (5%) dhe programe që ofrojnë punëtorë të kualifikuar (5%) janë nevojat tjera të rëndësishme që duhet të plotësohen në mënyrë që diaspora të jetë në gjendje të investojë në Kosovë. Qasja në tregje të huaja është e rëndësishme vetëm për disa (3%) nga pjesëmarrësit në studim nga diaspora që jeton në Gjermani.



Grafiku 8: "Lloji i përkrahjes që i nevojitet diasporës për të zhvilluar tutje biznesin e tyre në Kosovë"

Sa i përket llojit të përkrahjes që do t'ju nevojitej për të vazhduar me idetë dhe bizneset me interes, nevojat e diasporës nga Gjermania lidhen shumë me nevojat dhe kushtet e përgjithshme të klimës biznesore.

Nga diaspora që deklaroi të jetë e interesuar të investojë në Kosovë (44%), më tepër se çereku i tyre (29%) konsideron se funksionimi më i mirë i ligjit është përkrahja kryesore që do t'ju nevojitej për investim në biznes në Kosovë. Çështja e lehtësimeve dhe lirimeve nga tatimet janë stimulim për 18% të diasporës që kanë menduar të investojnë në Kosovë në 10 vitet e ardhshme. Pothuajse përqindje e ngjashme e pjesëmarrësve nga diaspora që jeton në Gjermani, pjesëmarrës në studim, konsideron se programet që ofrojnë punëtorë të kualifikuar (16%) dhe qasja në kredi me norma interesi të ulta (15%) si stimulim kryesor për investimet e tyre, përderisa rreth 11% konsideronin qasjen në tregje të huaja si të mirëseardhur.




Grafiku 9. Lloji i përkrahjes që i nevojitet diasporës si ndihmë për investim në Kosovë

Siç u përmend më herët në këtë raport, përqindje e konsiderueshme e të anketuarve nga diaspora e Kosovës që jetojnë në Gjermani nuk shprehën interesim për investime në biznes në Kosovë në 10 vitet e ardhshme. Në studimin tonë, ne ishim të interesuar të kuptojmë arsyet e tyre për këtë mungesë interesimi. Gjetjet e studimit zbulojnë se arsyeja kryesore për këtë mungesë interesimi për të investuar në Kosovë nga diaspora që jeton në Gjermani është pikërisht mungesa e sundimit të ligjit (37%). Kjo pengesë u theksua edhe nga të gjithë ekspertët e përfshirë në studim.

'Ligjet (në Kosovë) janë pengesë e zhvillimit ekonomik të vendit sepse nuk janë të harmonizuara. Ti përballesh me 5 ose 6 ligje nëse do të hapësh biznes. Njëri ligj të favorizon dhe tjetri të diskriminon, pra ka diskrepancë në mes të ligjeve. Në një pikë bëhet e pamundur të zhvillosh aktivitet ekonomik për shkak se baza ligjore të refuzon, mirëpo edhe kuptimet kontradiktore të

ligjeve. (Sipërmarrës nga diaspora e Kosovës që ka investuar në Kosovë, nëntor 2020)

Pothuajse çereku i të intervistuarve nga diaspora e Gjermanisë (23%) nuk kanë interesim të investojnë për shkak të politikave jo të favorshme, përdërisa disa nga ata konsiderojnë largësinë në mes shtetesh si çështje (6%). Çuditërisht, pak e konsiderojnë mungesën e burimeve njerëzore (4%) dhe faktin që Kosova është treg i vogël për të bërë biznes si arsye kryesore për të qëndruar larg.



Grafiku 10. Arsyeja kryesore pse diaspora nuk ka menduar të investoj në biznes në Kosovë

1.4. Të kthyerit dhe migrimi qarkor

1.4.1. Kosovarët e rikthyer dhe të riatdhesuar

Sipas Policisë dhe Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion, numri i personave të riatdhesuar (me forcë apo vullnetarisht) vetëm gjatë viteve 2013-2016, ishte 41,481, ku më tepër se gjysma (54%) ishin riatdhesuar me forcë përderisa pjesa tjetër (46%) vullnetarisht¹⁰.

Çështja e të kthyerve është temë në vete dhe kërkon studim të thellë mbi pengesat me të cilat ballafaqohen të kthyerit gjatë integritimit në shoqërinë kosovare. Megjithatë, për qëllime të këtij studimi, ne do të kalojmë shpejt nëpër çështje që kanë dalur nga intervistat me ekspertë.

Do të ishte e rrugës të fillohet me përfundimin se sipas shumicës së ekspertëve, të kthyerit nuk kthehen kurrë me vetë dëshirë. Në përgjithësi, ekspertët i grupojnë të kthyerit në dy grupe kryesore, ata që kishin zgjidhje të qëndronin jashtë por vendosën të kthehen qëllimisht dhe një pjesë e tyre që u kthyen për shkak të mungesës së dokumentacionit.

Përderisa përqindja e të kthyerve që zgjedhën të jetojnë në Kosovë konsiderohet e ultë, ekziston një bindje e përgjithshme që këta të kthyer kanë një plan dhe strategji paraprake, pak a shumë të

qartë dhe rrjedhimisht sfidat e tyre konsiderohen më pak të dukshme.

Lloji i vështirësive me të cilin përballet ky grup i të kthyerve varet shumë nga moshja dhe koha sa gjatë kanë qenë larg Kosovës, si dhe prej kategorisë të cilës i përkasin ky grup: vullnetarisht apo me forcë. Fëmijët dhe të rinjtë që kanë lindur në shtete tjera mund të përballen me problem të natyrës së njohjes dhe kuptimit të gjuhëve lokale në Kosovë, që si pasojë mund të ketë probleme komunikimi me moshatarët dhe krijon pengesë në mësim. Çështja e të kthyerve me forcë mbetet më brengosësja.

Çështja e papunësisë mbetet brengë për ta, siç është edhe çështje për ata që kanë jetuar vazhdimisht në Kosovë. Disa nga ekspertët e intervistuar konsiderojnë që procesi i riintegritimit mundësohet vetëm përmes marrëdhënieve familjare dhe ndihmës së familjarëve dhe jo sepse qeveria ka ndihmuar të kthyerit në këtë proces. Edhe pse përqindja e përfituesve të programit të riintegritimit në vitin 2016 ka arritur 44%, përderisa në vitin 2015 vetëm 15% përfituan nga ky program. Buxheti i alokuar për përkrahje ishte më i lartë në vitin 2015 sesa në 2016 (2015 - 2,112,671.00 Euro; 2016 - 2,001,719.00 Euro)¹¹.

Megjithatë, sipas disa ekspertëve të përfshirë në studimin kualitativ, këta të kthyer nuk janë mjaftueshëm të përgatitur për punë dhe duhet t'u

¹⁰ National Strategy for Sustainable Reintegration of Repatriated Persons in Kosovo 2018-2022, Ministry of Internal Affairs, 2017

¹¹ Strategjia kombëtare për riintegritimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në Kosovë 2018-2022, Ministria e Punëve të Brendshme, 2017

nënshtrohen programeve të ndryshme për punë specifike. Për më tepër, është theksuar nga disa ekspertë të intervistuar se të kthyerit mund të hasin në vështirësi në gjindshmëri për shkak të mungesës së njohurive në kulturën vendore të punës dhe mënyrës se si funksionojnë gjërat në vend.

Duke marrë parasysh nevojat e riintegrit, sipas zyrtarëve të Qeverisë të përfshirë në studim, Qeveria e Kosovës është duke projektuar një program të veçantë për përkrahjen e të kthyerve dhe lehtësimin e procesit të tyre të integrit në shoqëri 'të re', shoqëri kjo relativisht ndryshe nga ajo që kishin përjetuar jashtë vendit, me qëllim të lehtësimit të 'riintegrit të qëndrueshëm të të kthyerve'.

'Ne si qeveri, jemi duke punuar në krijimin e një programi për riintegrim dhe riatdhesim të të kthyerve, me një strategji të re të migrimit, e cila është duke u përgatitur me qëllim të përkrahjes së të kthyerve me forcë, përmes 'riintegrit të qëndrueshëm të të kthyerve'. (Përfaqësues i qeverisë, nëntor 2020)

Sipas përfaqësuesve të qeverisë të përfshirë në studim, qeveria ka krijuar infrastrukturën e nevojshme për koordinatorët regjional dhe përmes zyrës së tyre në aeroport. Qëllimi është të ofrohen informata dhe e gjithë mbështetja institucionale për të kthyerit vullnetarë, ku përfshihen informata mbi ndryshimet e fundit në vend, informata shtesë mbi mundësitë e stehimit dhe me qëra, si dhe

përkrahje financiare për të kthyerit që planifikojnë të hapin biznes.

'Për shembull, nëse i kthyeri dëshiron të hap biznes, ne ju ofrojmë emrat e kompanive që mund t'ju ndihmojnë atyre ta hapin atë biznes dhe ju ofrojmë atyre këshillim biznesor pa pagesë, dhe ju ofrojmë ndihmë financiare prej 3,000 Euro për biznese fillestare dhe ju qëndrojmë afër gjatë vitit të parë për çfarëdo që ju nevojitet. Përpos kësaj, për kompanitë që punësojnë, ne ju mbulojmë 50% të pagës së tyre për 12 muajt e parë. Ne poashtu ju ndihmojmë në rindërtimin e shtëpisë, renovim, mobilim, medikamente, etj., pra ne kemi programe specifike për secilën kategori të të kthyerve, duke i përkrahur në të gjitha aspektet, ekonomike, sociale, etj.' (Përfaqësues i qeverisë, nëntor 2020)

Megjithatë, të kthyerit nga Gjermania të përfshirë në studim duket se nuk kishin rast të përfitonin nga privilegjet e lartpërmendura. Përkundrazi, ata deklarojnë se qeveria nuk ka bërë asgjë për të përkrahur riintegrimin e tyre në shoqëri.

'Ne kemi hapur biznesin që pothuajse një vit dhe shteti (qeveria) nuk na ka ofruar asnjë lloj asistence për bizneset start-up ose fillestare, duke konsideruar problemet me të cilat përballemi ne. Do të ishte mirë që qeveria të përkrahte bizneset fillestare, së paku me paisje për fillim, dhe pastaj me gjëra tjera ' (I kthyer nga Gjermania në Kosovë, nëntor 2020)

'Të kthyerit përballen me shumë probleme, siç

janë strehimi, punësimi, kushtet e dobëta sociale, përkrahja e dobët nga shteti ose mungesa e plotë e përkrahjes. Nuk ka ndihmë, grante ose subvencione që na ofrohen nga shteti neve të kthyerve, gjë që na e vështirëson akoma më shumë. Nëse shteti do të na lidhte me grante përmes organizatave ndërkombëtare, merr shumë kohë. Unë kam pritur 2 vite për të marrë ndihmë nga këto organizata, duke ndjekur kështu trajnimin që ka qenë i obliguar. Pas trajnimit, kam pritur edhe 6 muaj që të marrë objektin me qera dhe më është dashur të paguaj vetë qeranë, sepse paratë nga granti janë vonuar. Ky model nuk ishte efektiv sepse unë harxhova të gjitha paratë duke pritur atë që më ishte premtuar. Shteti nuk bëri asgjë në këtë drejtim.' (I kthyer nga Gjermania në Kosovë, nëntor 2020)

Përderisa çështja e të kthyerve që janë kthyer pa vullnetin e tyre, konsiderohet si çështje që kërkon më shumë vëmendje, ekspertët e intervistuar besojnë se qeveria duhet të dizajnojë programe shitesë për 'tërheqjen e trurit nga jashtë' dhe kthimin e talentëve në Kosovë. Sipas disa ekspertëve, Kosova duhet të punojë drejt rritjes së transparencës dhe meritokracisë, veçanërisht për pozitat profesionale të punës në sektorin publik, me ç'rast do të ngrihet kualiteti i punonjësve të sektorit publik dhe perspektiva e punës për të kthyerit me shkathtësi.

'Një gjë që mund të bëhet është t'ju ofrohet më shumë barazi diasporës. Për shembull, nëse Universiteti i Prishtinës do të punësonte staf

akademik bazuar në meritokraci, ose nëse kështu do të bënin institucionet publike, institucionet qeveritare, nacionale ose lokale, atëherë kjo do të nxiste diasporën të konsiderojnë të kthehen në shtëpi dhe të japin kontributin e tyre dhe të provojnë të integrohen në shoqërinë kosovare. Në kushte të tanishme, ata (diaspora) mendojnë se është e pamundur t'i qasen tregut të punës në Kosovë, veçanërisht në sektorin publik' (Ekspert lokal dhe ndërkombëtar, nëntor 2020)

'Qeveria duhet të ketë program special me buxhet të përbashkët me donatorët, të alokuar, me strategji të qartë dhe vizion për sjelljen e këtyre ekspertëve [ekspertëve kosovarë që jetojnë jashtë vendit], të ketë buxhet për ta, t'u paguhen shpenzimet ditore dhe të rrugës sepse ky do të ishte investim i qëndrueshëm' (Përfaqësues i qeverisë, nëntor 2020).

Për të përmbyllur, gjetjet e studimit nuk tregojnë ndonjë përpjekje institucionale specifike në drejtim të 'tërheqjes së trurit nga jashtë' dhe kthim të talentave nga jashtë. Megjithatë, u theksua nga përfaqësuesit e Qeverisë se ka programe ekzistuese dhe është duke u punuar në programe shitesë për integrimin e të kthyerve që janë kthyer prapë në Kosovë.

'Jemi duke menduar të krijojmë një ueb faqe specifike që do të përmbante të gjitha informatat, adresat dhe kontaktet e personave të interesuar për t'u kthyer në Kosovë ... kështu, për të kthyerit dhe investitorët potencial, jemi duke

krijuar programe që do të lejonin ata të lidhen me institucionet ose personat që ju nevojiten, në mënyrë që të lehtësohet procesi i integritimit social dhe ekonomik' (Përfaqësues i qeverisë, nëntor 2020).

1.4.2. Migrimi qarkor

Koncepti i migrimit qarkor dallon nga shteti në shtet. Duket se ka mungesë harmonizimi edhe në mes të shteteve të BE-së^{12 13} sa i përket definimit dhe matjes së konceptit të migrimit qarkor. Në kuptim më të gjerë, migrimi qarkor nënkupton migrimin e përsëritshëm të një individi në mes të shtetit të origjinës dhe destinimit, respektivisht emigrantët që ndajnë punën, familjen dhe aspektet tjera të jetesës së tyre në mes të dy ose më shumë lokacioneve¹⁴.

Në shumë raste, migrimi qarkor është konsideruar me përparësi për të dy palët: shtetin e origjinës dhe shtetin e destinimit. Përderisa kjo do të ndihmonte shtetin e destinacionit t'i tejkalojë shpejtë mungesën e fuqisë punëtore në sektorë specifikë, shtetit të origjinës ia lehtëson punën duke ju ofruar punë fuqisë punëtore tepriçë, punësim për migrantët, paga më të larta dhe përvojë pune.

12 https://unece.org/fileadmin/DAM/stats/documents/ece/ces/bur/2016/February/14-Add1_Circular_migration.pdf

13 https://unece.org/fileadmin/DAM/stats/documents/ece/ces/bur/2016/February/14-Add1_Circular_migration.pdf

14 <https://www.migrationpolicy.org/sites/default/files/publications/Circular-Migration.pdf>

Edhe pse fenomen i zakonshëm, më i zakonshëm sesa që duket nga jashtë, migrimi qarkor nuk është koncept i qartë për shumicën e ekspertëve të intervistuar, veçanërisht në mënyrën si ndodh. Përderisa disa ekspertë të intervistuar e asocojnë këtë ndodhi me migrimin qarkor jo ligjor ose me ekonominë jo-formale, të tjerët e konsiderojnë si shkëmbim të kapitalit njerëzor dhe të ekspertizës.

Megjithatë, sipas secilit këndvështrim, nuk ka dilemë se diaspora Kosovare luan rol kyç, ose si ndërmjetësues ose si ofrues i drejtpërdrejtë i punës. Marrë parasysh se 400,000 anëtarë të diasporës janë vetëm në Gjermani, janë të pozicionuar mirë dhe të vendosur t'u ofrojnë antarëve të tyre të familjes që migrojnë nga Kosova, strehim dhe çfarëdo që ju nevojitet për fillim.

Për më tepër, perspektivat e ekspertëve të intervistuar dallojnë dukshëm sa i përket kësaj çështje. Përderisa disa nga ta e konsiderojnë migrimin qarkor si gjë pozitive për ekonominë e Kosovës dhe për zhvillimin e shkathtësive të punës së këtyre emigrantëve, ka edhe nga ata që besojnë se, në periudhë afatgjatë, migrimi qarkor mund të ketë ndikim negativ.

Megjithatë, motivet ose shtytësit e migrimit qarkor janë shumë të qarta. Përderisa shtetet si Gjermania ose Zvicra kanë nevojë për ndihmë nga punëtorët profesionistë ose gjysmë-profesionistë në sektorë specifikë, qytetarët kosovarë kanë nevojë për punë që ju paguhet. Përfaqësuesit e qeverisë të përfshirë në këtë studim pranojnë

përgjegjësinë për migrim dhe pajtohen se arsyeja për migrim të popullatës është plotësisht faji i shtetit që ka dështuar të siguroj punësim, siguri dhe mirëqenie të përgjithshme për ta.

Ekspertët e intervistuar që e konsiderojnë migrimin si pozitiv, argumentojnë se ky është një fenomen natyror global. Ekspertët nga Gjermania vazhdimisht zhvendosen në SHBA ose Kanada për punë më të mirë dhe kushte më të mira pune dhe kosovarët tregojnë praktika të njëjta, veçanërisht në rast se janë profesionistë, siç është sektori i teknologjisë informative. Në rast të Kosovës, sipas ekspertëve të përfshirë në studim, emigrantët qarkorë janë kryesisht të kyçur në ndërtim dhe prodhim, duke nënkuptuar që janë kryesisht puntorë gjysmë të kualifikuar.

'Ka shumë njerëz që punojnë në Gjermani dhe në Kosovë në të njëjtën kohë. Ka njerëz që vijnë në Kosovë për gjashtë muaj për të trajnuar të tjerët në sektorin e edukimit... Kemi rast kur personi nga Gjermania ka shkuar si konsulent në komunën e Hanit të Elezit për t'ju treguar si punohet dhe si të përmirësohet ambienti. I njëjti person ka shkuar edhe në Junik edhe në Han të Elezit t'ju jap rekomandimet lidhur me ambientin në komunat e tyre' (Sipërmarrës nga diaspora e Kosovës që ka investuar në Kosovë por jeton në Gjermani, nëntor 2020)

Përderisa migrimi afatgjatë (në Gjermani) konsiderohet si fuqizues sa i përket qëndrueshmërisë financiare, përmirësimit

të shkathtësive dhe ndoshta për krijimin e investitorëve potencial për Kosovë në të ardhmen, ekspertët ekonomik dhe disa investitorë të intervistuar për këtë studim, argumentojnë se migrimi qarkor i përkohshëm nuk e ka të njëjtin efekt. Përkundrazi, për momentin mund të jetë i dëmshëm, sepse nëse shumë njerëz e lëshojnë vendin, bie fuqia blerëse, reduktohet konsumi dhe kjo direkt ndikon në ekonomi. Shumica e njerëzve që largohen nga Kosova nuk kanë ndonjë kualifikim dhe kjo ka ndikim negativ sepse konsiderohet se ata nuk do jenë në gjendje as të kursejnë mjaftueshëm para për t'ju dërguar anëtarëve të familjes në Kosovë. Gjithashtu, çështjet sikurse pranimi social nga shteti i destinacionit, dikriminimi dhe tjetërsimi, janë brenga që duhet të konsiderohen poashtu në llogaritje.

'Një industri e tërë që ka vuajtur nga ky lloj migrimi është industria e drurit, ku në një fshat në Ferizaj të quajtur Greme, një numër i madh i popullsisë ka migruar në Gjermani dhe as pagat nuk ishin aq të larta, diku rreth 1200 ose 1300 euro, përderisa këtu paguheshin 600 ose 700 euro. Nëse i heqim taksat dhe qëranë në Gjermani, ushqimin, etj., i bie që nuk ia vlenë ta lësh familjen dhe shtetin' (Ekspert lokal dhe ndërkombëtar, nëntor 2020).

Është e arsyeshme të argumentohet megjithatë, që nëse emigrantët nuk kanë shkathtësi, ata do të ishin të papunë në Kosovë. Për shkak të papunësisë, fuqia blerëse do të ishte e kufizuar dhe nuk do të ishin në gjendje të fitonin shkathtësi të reja, përderisa migrimi qarkor në anën tjetër, do

t'ju ofronte emigrantëve mundësi për të mësuar shkathtësi të reja, të rrisë të ardhurat dhe t'i përkrahë familjarët në Kosovë.

Gjithashtu, disa ekspertë të intervistuar besojnë që të ardhurat nuk janë i vetmi nxitës për migrim, por janë edhe përfitimet plotësuese që shtetet si Gjermania ofrojnë, siç janë sistemi i mirëfilltë shëndetësor dhe sistemi i mirëfilltë i edukimit për fëmijët e emigrantëve.

Pavarësisht nga arsyeja apo forma në të cilën shfaqet, përfaqësuesit e qeverisë, pjesëmarrës në studim, besojnë se migrimi është proces i vështirë të kontrollohet. Sipas Institutit për Politika të Migrimit (Graeme Hugo, 2013), menaxhimi efektiv i migrimit qarkor me qëllim të mundësimit të zhvillimit dhe reduktimit të varfërisë kërkon bashkëpunim edhe në mes të qeverive të dy shteteve, por edhe në mes të agjencive të migrimit të shtetit të origjinës dhe të destinacionit¹⁵.

Ekspertët e përfshirë në studim besojnë po të njëjtën gjë; mënyra e duhur që të kemi së paku ndonjë lloj kontrolli mbi të është duke krijuar më tepër kompani rekrutimi, përmes të cilave ata punësojnë njerëz nga Kosova për të punuar në Gjermani. Megjithatë, marrë parasysh se

¹⁵ <https://www.migrationpolicy.org/sites/default/files/publications/Circular-Migration.pdf>

agjencionet e migrimit tashmë operojnë në Kosovë, veçanërisht për sektorin shëndetësor në Gjermani, kjo megjithatë nuk i dha Qeverisë së Kosovës kontrollë më të mirë mbi migrimin.

Për më tepër, disa ekspertë besojnë se qeveria duhet të krijojë sistem edukimi dhe trajnimi, përmes të cilave njerëzit do të mund të krijojnë shkathtësi që do t'ju mundësojnë popullatës që të punojnë nga Kosova pa u zhvendosur në Gjermani, duke nënkuptuar kështu trajnime për të krijuar ekspertë të teknologjisë dhe ekspertë në fusha të ngjashme.

Për të përmbyllur, koncepti i migrimit qarkor është koncept i ndërlikuar dhe i paqartë, kryesisht rreth shpeshhtësisë që ndodh në aspekt të numrit të emigrantëve dhe më e rëndësishmja, si ndodhë dhe cilat janë përfitimet e migrimit qarkor në përgjithësi. Të gjeturat mund të tregojnë mungesë të diskutimit publik mbi definimin e migrimit qarkor filimisht dhe akoma më pak diskutime mbi përfitimet potenciale që ky lloj migrimi mund t'i sjellë shtetit të origjinës.

Diskutime dhe Rekomandime

Diaspora, siç tregojnë gjetjet e studimit, është jashtëzakonisht shumë e kyçur në jetën e njerëzve në Kosovë, më shumë e nxitur nga lidhja emocionale dhe familjare sesa nga ndonjë shtytës tjetër. Ndikimi i tyre në shoqëri, edhe pse individual dhe plotësisht i pastrukturuar, përmes remitancave, vizitave të shpeshta, investimeve në biznese dhe mundësitë të migrimit qarkor, prek jetën e një pjese të madhe të popullatës në Kosovë në formë jashtëzakonisht pozitive, përkrahje në të mirë dhe në të vështirë, dhe më e rëndësishmja, pa kushte.

Kjo lidhje, edhe pse vazhdon tanimë që disa dekada, përballet me rrezik të shuarjes karshi ndryshimeve në vlera familjare, p.sh. transformimi nga një shoqëri kolektive në një më individuale. Përderisa gjenerata e diasporës që ka migruar në Gjermani para vitit 1999 mund të jetë moshuar tani dhe e paaftë për të përkrahur anëtarët e familjes në Kosovë pas pensionimit të tyre, fëmijët e tyre vështirë se mund të jenë të interesuar të përkrahin financiarisht të afërmit e tyre që jetojnë në Kosovë, veçanërisht nëse mbështetet vetëm në lidhjen e tyre emocionale, e cila mund të zbehet për shkak të dinamikës së jetës.

Përderisa ndihma e tyre është përfituese për Kosovën, kanalizimi i të hyrave financiare nga

diaspora në mënyrën që jep prodhimin më të mirë dhe ka ndikim më të madh sesa kryesisht të fokusuar në konsum financiar, shihet si absolutisht e domosdoshme nga shumica e ekspertëve të përfshirë në studim. Për ta bërë këtë, ky studim rekomandon të ndërmerren këta hapa.

Mundësimi i investimeve potenciale. Siç nxjerrin të dhënat e studimit, ka një përpjekje nga qeveria, investitorët e diasporës, popullata e diasporës në përgjithësi dhe nga odat ekonomike dhe organizatat, që të shërbejnë si urë lidhëse në mes të Kosovës dhe botës së jashtme, veçanërisht diasporës. Secili nga këta punon në drejtimin që mendojnë se është i duhuri, por pa ndonjë strategji të qartë afatgjate dhe plan drejt qëllimit të përbashkët.

Kjo mungesë koordinimi po rezulton në shumë punë të pavërrejtshme për të gjitha palët e interesit, pa përjashtime. Përderisa qeveria ndjek shtegun e tyre dhe beson se është duke pasur ndikim në popullatën në shënjestër, popullata në cak nuk i vëren përpjekjet e Qeverisë, dhe e kundërta. Duket se ka një plasaritje në zinxhirin e komunikimit në mes të akterëve kyç në këtë çështje. Është e rëndësishme të theksohet që të gjithë akterët kyç në këtë çështje vështrojnë në drejtim të qeverisë, roli dhe aktivitetet e të cilës shihen si të domosdoshme në menaxhimin dhe

organizimin e strukturave të marrëdhënies në mes të akterëve kyç në Kosovë dhe diasporë.

Si rezultat, rekomandohet që institucionet qeveritare përgjegjëse për çështjen e diasporës dhe investimeve të huaja, të forcojnë marrëdhënien e tyre me akterët kyç në diasporë dhe me odat ekonomike (kombëtare dhe bilaterale).

Është një indikacion që plani strategjik ekzistues i qeverisë për diaporën 2019-2021 nuk është shumë i qartë ose ka vështirësi në zbatim të mirëfilltë. Ky plan ka nevojë për konsultim të thellë me partnerët strategjik dhe ekspertët e ekonomisë, në mënyrë që të maksimalizohet ndikimi i tij dhe të formulohet plani pasardhës për 2022-2024.

Përgjatë gjithë studimit është e qartë se ka boshllëqe në interpretimin dhe implementimin e ligjeve lidhur me investimet e huaja. Këto boshllëqe duhet të identifikohen, largohen dhe më e rëndësishmja, të komunikohen përpjekjet dhe rezultatet tek diaspora.

Lehtësimi i tatimeve konsiderohet si prioritet urgjent nga të gjithë ekspertët e përfshirë në studim dhe konsiderohet si hap konkret përpara drejt tërheqjes së investimeve të huaja. Procesi i marrëveshjes duhet të inicohet me shtetet relevante, Gjermaninë në veçanti, në mënyrë që investimi të jetë më tërheqës.

Mungesa e burimeve njerëzore të kualifikuara,

ose më saktësisht, numri i pamjaftueshëm i punëtorëve të kualifikuar, është një tjetër pengesë e identifikuar me të cilën përballen investitorët potencial, kur shohin për mundësitë e investimit potencial në Kosovë. Prandaj, rekomandohet identifikimi i nevojave të investitorëve potencial lidhur me burimet njerëzore si dhe krijimi i programeve për të përmbushur boshllëkun,

'Kthimi i trurit nga jashtë'. Edhe pse vend i varfër dhe me shumë problem sociale dhe ekonomike, për shumicën e ekspertëve në studimin kualitativ Kosova konsiderohet si vend atraktiv për të jetuar, veçanërisht për shkak të marrëdhënieve sociale dhe ndihmës familjare. Kjo qëndron edhe më shumë nëse arrijnë të marrin një punë përmbushëse dhe plotëson nevojën e tyre për kontribut për atdhe.

Politikat progresive duhet të konsiderohen për të tërhequr diasporën me shkathtësi pune në tregun ekonomik të vendit të tyre të origjinës, ku ata do të mund të aplikojnë shkathtësitë e tyre profesionale. Përfaqësuesit e Qeverisë besojnë që duhet të hartohet një strategji specifike, me një buxhet të alokuar për punësimin e ekspertëve nga diaspora për projekte afatshkurte, në mënyrë që të kenë mundësi të kontribuojnë në vend me ekspertizën e tyre, dhe në të njëjtën kohë, të forcojnë lidhjet e tyre me anëtarët e familjes në shtetin e tyre të origjinës. Disa ekspertë besojnë që në mënyrë që kjo të fillojë, do të mjaftonte që procesi i punësimit në sektorin publik të jetë transparent dhe i hapur për aplikim vetëm për diasporën. Gjithashtu, një fond i veçantë që përkrah studentët e dalluar të

diasporës, në periudhë afatgjate do të kontribuonte në 'kthimin e trurit' sipas ekspertëve të përfshirë në studim.

Sektori i Teknologjisë Informative. Është e dukshme se investimi i diasporës në sektorin e teknologjisë është shumë i ultë, pavarësisht që diaspora në Gjermani është kryesisht e angazhuar në sektorin e ndërtimit dhe pavarësisht që sektori i teknologjisë informative mund të jetë fushë e panjohur për ta si mundësi biznesi. Rekomandohet që OEGJK të përmbushë këtë boshllëk.

Të kthyerit. Ka indikacion që ka mungesë të plotë ose të pjesshme të njohurisë mbi skemat mbështetëse për të kthyerit. Prandaj, rekomandohet që Qeveria të komunikojë më aktivisht skemat ekzistuese të mbështetjes për të kthyerit.

Tema e të kthyerve është tejet komplekse dhe ka nevojë të eksplorohej më afër dhe të elaborohet si studim i veçantë. Çështja e riatdhesimit dhe riintegrit, llojet e vështirësive me të cilat përballen të kthyerit, si dhe politikat potenciale që do të mund të kontribuonin në ekonominë e Kosovës nga kthimi i tyre, kanë nevojë për eksplorim dhe shpjegim më të thellë.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, është nevoja për rindërtim të një imazhi pozitiv të Kosovës në sytë e diasporës dhe investitorëve ndërkombëtar. Ekziston një perceptim i përgjithshëm që Kosova është një vend i vogël që përballlet me varfëri,

korrupsion, mungesë të funksionimit të ligjit, nepotizëm, mungesë të profesionistëve dhe me karakterizime tjera që ndikojnë negativisht në investitorët potencial. Si çështje që kërkon adresim urgjent, qeveria duhet të punoj në një strategji që tregon përpjekje të dukshme drejt luftimit të korrupsionit dhe nepotizmit, veçanërisht përmes transparencës publike.

Është e pashmangshme të theksohet se është e mundur që brenda secilës temë në këtë studim, të ketë çështje më të thella të cilat janë mbuluar sipërfaqësisht ose që nuk kanë dalur, kryesisht për shkak të numrit të madh të temave të përfshira në këtë studim. Prandaj, rekomandohet të bëhet një analizë plotësuese për secilën temë të shtjelluar, në mënyrë që të thellohem më tepër në secilin problem.

Shtojca 1.

Pyetësor për hulumtim

Hulumtim me diasporën shqiptare në Gjermani

Kantar me Odën Ekonomike Gjermano- Kosovare është duke kryer një hulumtim me diasporën shqiptare në Gjermani dhe do të vlerësonim shumë nëse i ndani disa minuta për t'iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme. Përgjigjet tuaja do të jenë plotësisht sekrete, në pajtim me standardet ndërkombëtare të hulumtimit.

PJESA KRYESORE

P-1. A keni investuar ju apo familja juaj në ndonjë biznes në Kosovë në 10 vitet e fundit?

1	Po	VAZHDO NË P-2
2	Jo	KALO NË P-4
3	Refuzoj	KALO NË P-4

P-2. Në cilin sektor funksionon biznesi në të cilin keni investuar në Kosovë?

P-3. Çfarë përkrahje do t'ju nevojitej për të zhvilluar më tutje biznesin tuaj në Kosovë?

PËRGJIGJE E SHUMËFISHTË

1	Ofrimi i qasjes në tregje të huaja
2	Lehtësime tatimore nga shteti
3	Sundim më i mirë i ligjit
4	Programe për ofrim të punëtorëve të kualifikuar
5	Qasje në kredi me interesa të favorshëm
6	Tjetër, përcakto

P-4. A keni menduar që ju apo familja juaj të investoni në ndonjë biznes në Kosovë në 10 vitet e ardhshme?

1	Po	VAZHDO NË P-5
2	Jo	VAZHDO NË P-7
3	Refuzoj	VAZHDO NË P-8

P-5. Në cilin sektor keni menduar të investoni në Kosovë?

P-6. Çfarë përkrahje do t'ju nevojitej për të ndihmuar investimin tuaj në Kosovë?

PËRGJIGJE E SHUMËFISHTË

1	Ofrimi i qasjes në tregje të huaja
2	Lehtësime tatimore nga shteti
3	Sundim më i mirë i ligjit
4	Programe për ofrim të punëtorëve të kualifikuar
5	Qasje në kredi me interesa të favorshëm
6	Tjetër, përcakto

P-7. Cilat janë arsyt kryesore pse nuk keni menduar të investoni në ndonjë biznes në Kosovë?
RROTULLO RENDITJEN. PËRGJIGJE E SHUMËFISHTË

1	Tregu i vogël në Kosovë
2	Politikat e pafavorshme shtetërore
3	Mungesa e sundimit të ligjit
4	Mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar
5	Distanca e madhe nga Kosova
6	Tjetër, përcakto

P-8. A keni biznes privat ju apo familja juaj në Gjermani?

1	Po	VAZHDO NË P-9
2	Jo	KALO NË D-1
3	Refuzoj	KALO NË D-1

P-9. Në cilin sektor funksionon biznesi juaj në Gjermani?

DEMOGRAFIA

D-1. Gjinia 1. Mashkull 2. Femër

D-2. Moshë _____ _____

D-3. Ju lutem më tregoni sa anëtarë jeni në familjen tuaj, duke përfshirë edhe veten? _____ anëtarë

D-4. Nëse do të ishit i/e gatshëm/me të merrni pjesë në hulumtimet tjera në të ardhmen, ju lutem a mund të shkruani e-mailin tuaj më poshtë?

JU FALEMINDERIT PËR KOHËN TUAJ!

Shtojca 2.

Udhëzues për diskutim

Udhëzues për intervista të thella

Prezantimi

1. Intervistues: fillo me sqarimet rreth situatës dhe rregullave të intervistës:
 - Neve na nevojitet opinioni juaj i sinqertë, përshtypjet dhe perceptimet
 - Nuk ka përgjigje të drejtë ose gabim, të mirë apo të keqe
 - Por më e rëndesishmja është të sqaroni arsyen pse e keni ju këtë opinion
2. Konfidencialiteti- përgjigjeve do të ju ruhet anonimiteti
3. Procesi- diskutimi (biseda), do të inqizohet
4. Prezantimi i shkurtër i folesit(emri, mbiemri, moshë, statusi familjar, profesioni dhe puna e tyre)

Diskutimi

1.Çfarë mund të na thoni për ndikimin e Diasporës së Kosovës në ekonominë dhe në mirëqenien e Kosovës në përgjithësi? (provo nëse nuk është specifik: a ka një ndikim signifikant?).

2.Po prezenca e biznesve të hapura nga Diaspora e Kosovës në Kosovë? A mund të na thuani sa është e rëndësishme prezenca e tyre në Kosovë? A kane ndonjë ndikim? Nëse po, si? (ju lutem specifikoni). (provo nëse nuk e përmend spontanisht: çfarë mund të na thoni për ndikimin e tyre në zhvillimin ekonomik të vendit? Pse?)

3.A mendoni se është punuar mjaft për të lehtësuar dhe stimuluar investimet dhe për tu zhvilluar bizneset e diasporës në Kosovë? Pse mendoni kështu? Çfarë duhet të bëjë më shumë Qeveria e Kosovës për të stimuluar lidhjet nga diaspora me bizneset e hapura jashtë Kosovës? Çfarë politika duhet të përdorë, ose cilat hapa duhet ndjekur (ose të ndërmerren)?

4.Po faktorët tjerë (përpos Qeverisë)? Kush duhet bërë çka? Si mund të bëhet diaspora pjesë e zhvillimit të vendit në të ardhmen? Cili mund të jetë ndikimi dhe pjesëmarrja e tyre? Cilat janë hapat që duhet të ndërmarrim ne si shtet, në mënyrë që të lehtësojmë përfshirjen e tyre në zhvillimin e ardhshëm të Kosovës? Çfarë duhet bërë tutje? Kush mendoni se duhet të merret me këtë?

5.Çfarë mendoni ju, cili është ndikimi i remitancave specifikisht në zhvillimin ekonomik të vendit? A besoni ju se këto e stimulojnë zhvillimin ekonomik? Si ashtu (specifiko)? Çfarë mendoni për ndikimin social që kanë remitancat në Kosovë? Si mendoni që ndikojnë ato në vlerat e shoqërisë kosovare? Pse mendoni kështu?

6.A mendoni se momentalisht remitencat janë duke u përdorur në mënyrë produktive? Çfarë duhet ndryshuar këtu? Si mund të përdoren ato në mënyrë me produktive? Çfarë politika/hapa duhet Qeveria e Kosovës të implementojë në mënyrë që të mbeshtes këtë proces? A keni ndonjë shembull se çfarë kanë bërë shtetet tjera për të marrë ne atë si model?

7. Të ndryshojmë temën pak- sa e involvuar mendoni se është diaspora në migrimin e shumfishtë? Pse kështu? Si mund të jetë diaspora më mirë e përfshirë në këtë proces? A mendoni se diaspora jone punon edhe në Kosovë edhe jashtë vendit kohë pas kohe? Si duhet të nxitet përfshirja e tyre? Cfarë duhet bërë vendimarrësit e përfshir lidhur me këtë çështje?

8. Me cilat sfida përballen të kthyerit potencial? Ndonjë tjetër? Si mund të integrohen ata në mënyrë efektive në ekonominë e brendshme dhe në shoqëri? Ndonjë alternativë tjetër?

Ju faleminderit për pjesëmarrjen tuaj!

Shtojca 3. LETRA E INFORMIMIT

I/e nderuar,

Misioni i Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK) në bashkëpunim me Kantar (Index Kosova) është duke kryer një studim mbi përfshirjen e Diasporës në zhvillimin ekonomik të Kosovës në të ardhmen.

Objektivi kryesor i këtij studimi është të identifikohen problemet që po e pengojnë Diasporën për të investuar në Kosovë, por gjithashtu për të ofruar rekomandime se si ta përdorim potencialin e Diasporës sonë në Gjermani për zhvillimin ekonomik të vendit, duke i shfrytëzuar remitancat në mënyrë më produktive.

Të gjeturat e këtij studimi do të ofrojnë informacione që do të shërbejnë në forcimin e kornizës ligjore dhe të politikave me qëllim tërheqjen dhe rritjen e investimeve nga Diaspora, duke ofruar rekomandimet se si t'i përdorim remitancat në mënyrë më produktive.

Ju jeni identifikuar si një person kyç në këtë studim dhe kontributi juaj do të jetë shumë i vlefshëm për të gjeturat e këtij studimi.

Për pyetje dhe komente tjera, ju lutem të ndjeheni të lirë të kontaktoni Nora Hasani (nora.hasani@oegjk.org) ose Vlora Basha (v.basha@indexkosova.com).

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj!

Nora Hasani (KDWW)

Vlora Basha (Kantar)

